



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 98 prot.

Tiranë, më 13. 01. 2022

V E N D I M

Nr. 14 , datë 13.01. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shqyrtoi ankesën nr. 58 regj, datë 19.06.2020, paraqitur nga ankuese A.B, kundër znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe ankesës që ka bërë në drejtim të drejtueses së institucionit arsimor. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja parashtron se, është mësuese e histori-geografisë, në fushën shoqëria dhe mjedisi, pranë institucionit arsimor “Dora d’Istria”, Tiranë. Ankuesja deklaron se, është emëruar në këtë pozicion pune para 5 vitesh, më datë 17.03.2015 si fituese e vendit të parë të Portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Dy vitet e fundit pranë kësaj shkolle ankuesja shprehet se ka përjetuar shqetësime të vazhdueshme gjatë gjithë vitit mësimor, që lidhen kryesisht me marrëdhëniet e punës me kolegët dhe me drejtuesen e institucionit arsimor. Situata e diskriminimit në ambientin e punës ka precipituar, sipas saj, pas një ankese të bërë në drejtim të drejtoreshës së institucionit znj. E.H, që mban datën 14.02.2020, dhe ka sjellë për pasojë dhënien e masave disiplinore të padrejta ndaj ankuseses, në kundërshtim të hapur me parimet themelore të Kodit të Punës, Kodit të Procedurave Administrative, Rregulloreve që normojnë procesin mësimor në institucionet parauniversitare.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesja pretendon se, procedimi në Komisionin e Etikës, është bërë pa dijeninë dhe pjesëmarrjen e saj. Gjatë procedimit në Komisionin e Disiplinës, ankuesja deklaroi se nuk është lejuar të flasë, të trajtojë argumentat e saj ligjor dhe se është ndjerë në presion dhe e dhunuar psikologjikisht përgjatë gjithë procesit dhe se nuk është lejuar të njihet me aktet dhe provat ku bazohen shkeljet e pretenduara. Ndaj saj është dhënë një masë flagrante “paralajmërim për largim nga puna”, e cila është masa e parafundit që jepet ndërkohë që masat jepen sipas parimit të përshkallëzimit, duke filluar nga “Qortimi”. Dhënia e kësaj mase, pa arsytim, pa argumentim në asnjë rrethanë, vërteton faktin e diskriminimit në drejtim të procedimit disiplinor, me qëllim të plotë largimin nga puna.

Ankuesja sqaron situatën pse lindi konflikti dhe u mblodh Komisioni Etikës, e në vijim Komisioni Disiplinës, si më poshtë vijon:

Në datën 23 janar 2020, ankuesja shprehet se ka ndodhur një incident me fshehjen e regjistrave të klasës 9a dhe 9b, javë gjatë të cilës ajo ishte në dezhurn së bashku me mësuesen H.Sh. Pas përfundimit të orës së gjashtë dhe pasi këta regjistra ishin dorëzuar në nëndrejtori sipas rregullit, nuk gjendeshin edhe pas njoftimit të bërë nga nëndrejtoresha V.D dhe ankuesja. Ankuesja deklaroi se është njoftuar se regjistrat u gjetën pas orës 14.30, pasi ishin marrë nga mësuese B, pa njoftuar. Lidhur me këtë problematikë mori dijeni edhe drejtoresha. Në përfundim të orës së 7-të (ora 13.45) vjen mësuese I.M, e cila pasi merr regjistrin nga mësuese B., komunikoi se e kish njoftuar drejtoresha për ta marrë. Sipas ankueses, kjo mësuese pasi doli nga klasa 8c me regjistrin e klasës 9b në dorë, është pyetur nga ankuesja se mos ndodhej dhe regjistri i klasës 9b, por mësuesja I. M. i pohoi se nuk ndodhej. Ankuesja shprehet se nuk ishin larguar me nëndrejtoreshën deri në gjetjen e regjistrit të klasës 9a dhe për këtë u mbajt dhe shënim në regjistrin e dezhurnit.

Në datën 24 janar 2020, ditë e premte, pas përfundimit të orës së fundit të mësimi, pasi ankuesja ka hyrë në ambientet e klasës kujdestare 8b, ka gjetur 2 kanaçe pijesh energjike bosh. Të nesërmen, ditë e shtunë (ishte mësim), ankuesja ka marrë vesh se ato ishin konsumuar nga dy nxënës S. Ç. dhe A. D. Ditën e hënë, ankuesja u ka tërhequr vëmendjen nxënësve gjatë orës së kujdestarisë, ku u trajtua ky problem. Ankuesja pretendon se, nga telefoni i saj po atë ditë janë fshirë mesazhe me përmbajtje jo korrekte që i ishin dërguar nga nxënësja S. Ç. Për të komunikuar me prindërit e nxënësës, ankuesja ka kërkuar ndihmën e drejtoreshës.

Në datën 28 janar 2020, pas mbarimit të orës së gjashtë, ankuesja ka shkuar në ambientet e klasës kujdestare 8b. Në klasë, ankuesja shprehet se ndodheshin mësuese I.M, psikologjia e shkollës dhe nxënësja S. Ç, ndërkohë që në klasë nuk ndodhej asnjë nxënës tjetër, pasi mësimi kishte 12 minuta që kishte përfunduar. Ankuesja sqaron se nxënësja S.Ç. shkon në shtëpi me furgon dhe zakonisht del e para nga klasa dhe thekson se, psikologjia nuk mund të marrë asnjë nxënës pa patur paraprakisht lejen nga prindërit, gjë që nuk e ka për asnjë fëmijë të klasës 8b, pasi prindërit kanë refuzuar ta japin që në kërkesën e saj me shkrim në muajin tetor 2019.

Në datën 29 janar 2020, në sallën e mësuesve, ankuesja deklaroi se i është drejtuar mësueses I. M. me fjalët: *“Pse ndërhyr në punët e klasës sime dhe në punën time (duke iu referuar punës së regjistruar) kur unë nuk përzihem në punët e tua? Punët janë të ndara, ti në hapësirën tënde e unë në hapësirën time.”* Sipas ankueses, në këtë moment ka ndërhyrë mësuese A. L., duke thënë me zë të lartë: *“Ta heqim këtë mësuese”*. Ankuesja shprehet se pavarësisht provokimit të rëndë ka preferuar të mos përgjigjet. Ankuesja deklaroi se po atë ditë, ka vënë në dijeni drejtoreshën në lidhje me problematikën me mësuese I. M., e cila i ka komunikuar se janë gjëra që zgjidhen pa problem.

Në datën 12 shkurt 2020, ankuesja deklaroi se, pasi kishte marrë njoftimin një ditë më parë nga dy anëtarët e Komisionit të Etikës, i është komunikuar nga kryetarja e këtij Komisioni, mësuese L. A., se ishte paditur nga mësuese I. M., me pretendimin se kishte kërcënuar atë dhe të gjitha mësueset e shkollës se do t'i hiqte nga puna. Sipas ankueses, një pretendim ky i pabazuar. Pasi është njohur me ankesën ka kundërshtuar çdo pretendim. Pas deklarimit mësuese I. M. është lënë e lirë të shkonte, ndërsa sipas ankueses kjo e fundit është mbajtur dhe dy orë të tjera duke iu kërkuar nga kryetarja e Komisionit L. A. që të firmoste procesverbalin. Ankuesja pretendon se fjalët e saj nuk ishin cituar korrekt dhe ishin shënuar shumë të pavërteta dhe për këtë arsye ajo kishte kërkuar të vendoste shënimin e saj në procesverbal, por nuk është lejuar dhe nuk i është dhënë mundësia që të ketë një kopje të ankesës. Po këtë ditë, ankuesja deklaroi se është paraqitur në ZVAT në lidhje me këto shqetësime, por i është sugjeruar që të bënte një ankesë me shkrim. Në datën 13 shkurt 2020, ankuesja deklaroi se ka qenë me raport mjekësor.

Në datë 14 shkurt 2020 ankuesja deklaroi se është thirrur nga Komisioni i Etikës, pas orës së 4 të mësimin, pa një njoftim paraprak zyrtar. Ajo ka kërkuar nga komisioni që të thirrej një ditë tjetër pasi për arsye shëndetësore nuk mund të merrte pjesë, por një kërkesë e tillë nuk është pranuar. E ndodhur në këto kushte, për të shmangur çdo pasojë negative është detyruar të marrë pjesë. Në takimin e Komisionit të Etikës kanë marrë pjesë anëtarët e këtij Komisioni (mësuese L. A., M. Sh., M. B. dhe A. K.), mësuese I. M. dhe pas një ore janë thirrur psikologjia dhe nxënësja e klasës së ankueses S. Ç. Ankuesja shprehet se, në deklaratimet e tyre si nxënësja S. Ç. ashtu dhe psikologjia pohuan faktin se mësuese I. M. kishte qenë në klasë në datë 28 janar 2020, rreth 12 min pas përfundimit të orës së mësimin bashkë me psikologun e shkollës dhe nxënësen S. Ç., e cila po shkruante diçka në fletë, të cilat janë larguar të treja nga klasa 8b. Ankuesja ka pretenduar pranë Komisionit të Etikës se sipas Dispozitivave Normative (DN), është mësuesi kujdestar ai që bashkëpunon me prindin e nxënësit me probleme në sjellje dhe psikologun e jo mësuesi lëndor. Në përfundim të takimit, ankuesja ka kërkuar të vendosë shënimin në procesverbal, pasi ka konstatuar se fjalët e saj nuk ishin cituar drejt, por kjo kërkesë është refuzuar. Në datën 17 shkurt 2020, ankuesja ka depozituar një kërkesë me shkrim dhe ka kërkuar që ti vihen në dispozicion kopjet e procesverbaleve të datës 12 dhe 14 shkurt 2020 dhe kopje të provave, si një e drejtë ligjore e saj. Pas kësaj kërkesë ankuesja pretendon se ka patur një përgjigje aspak etike, nga një prej anëtarëve të komisionit, mësuese M. B. Ankuesja shprehet se ka vendosur në dijeni drejtoreshën duke i kërkuar që të mbante një qëndrim për situatën. Ankuesja shprehet se ka pritur për një ballafaqim,

sikundër i ishte premtuar, por nuk pati asnjë reagim as atë ditë as ditët në vijim. Që nga data 17 shkurt 2020 e në vijim, ankuesja deklaroi se nuk pati asnjë komunikim ose përgjigje zyrtare nga Komisioni Etikës lidhur me çështjen.

Përpos sa më sipër, ankuesja shprehet se kundër saj janë përfshirë prind dhe nxënës, të cilët bëhen objekt i një ankese krejt pa baza në Ministri. Ankuesja deklaroi se përgjatë procedimit në Komisionin e Disiplinës, është trajtuar problematika për vendosjen e notës 9 një nxënëseje të klasës IX, ndërkohë që nxënësja dhe prindërit pretendonin në mënyrë të pamertuar notën 10. Ankuesja shprehet se, pavarësisht se në takimin e mbajtur në shkollë në datën 26 maj 2020, vuri në dispozicion të drejtoreshës të gjithë dokumentacionin që hidhte poshtë pretendimet e prindit dhe nxënësit, sjellja drejtoreshës ka qenë diskriminuese deri në marjen e masës ekstreme, tërësisht në shkelje ligjore. Në këtë takim ankuesja shprehet se drejtoresha i ka bërë presion se përse nuk e kishte marrë privatisht nxënësen dhe ti premtonte notën 10 si përfundimtare, kur rezultatet dilnin në qershor. Ankuesja pretendon se edhe e-maili i datës 29 maj 2020, ku ajo është urdhëruar nga drejtoresha që të marrë prindin në telefon, pasi në të kundërt do të ndëshkohesha me masë, është tejet kërcënues dhe diskriminues.

Ankuesja shprehet se është denigruese kërkesa e drejtoreshës për masë të tejkaluar disiplinore, e diferencuar dhe totalisht jo proporcionale, ndaj saj, ndërkohë që, mësues të tjerë të këtij institucioni, kanë vlerësuar me notën 4, minimalisht 2 nxënës, në shkelje të urdhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe nga ana e drejtoreshës së institucionit, nuk ka nisur asnjë procedim apo trajtim të vendosjes së një note jo kaluese nga ana e këtyre mësuesve. Ankuesja pretendon se, ndërhyrjet në vlerësimin objektiv të nxënësve nga ana e saj, janë jo vetëm të padrejta por edhe diskriminuese në drejtim të profesionit të saj si mësuese.

Në përfundim ankuesja kërkon nga Komisioneri që të konstatoj diskriminimin e saj dhe anulimin e çfarëdo lloj shkrese/mase disiplinore apo çdo lloj situatë diskriminuese ndaj ankuseses.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, *mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata*

ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë

1. Me shkresën me nr. 882 prot., datë 01.07.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Me shkresën nr. 233 prot., datë 13.07.2020², znj. H, ka kthyer përgjigje, duke parashtruar si më poshtë:

Znj. H, në cilësinë e Drejtores së Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, informon se masa disiplinore “*paralajmërim për largim nga puna*” për ankuesen A.B, është dhënë si rezultat i dy procedurave disiplinore, dhe konkretisht:

- a. Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Etikës së kësaj shkolle, datë 17.02.2020, lidhur me ankesën e mësueses I. M. ndaj mësueses A.B;

Në lidhje me këtë çështje, E.H, shpjegon se, Komisioni i Etikës i ngritur pranë institucionit arsimor, kishte paraqitur pranë Komisionit të Disiplinës, praktikën pas verifikimit të ankesës së znj. I.M. ndaj znj.A.B, të dyja mësuese pranë kësaj shkolle. Nga praktika e paraqitur, rezultoi i provuar pretendimi i znj. I. M, se gjatë ushtrimit të detyrës ajo ishte fyer dhe kërcënuar nga mësuesja znj. A.B. Këto pretendime vërtetohen nga pyetja dhe ballafaqimi i mësueve prezent në momentin e ngjarjes, nga ballafaqimi me psikologun znj. L.B. dhe nxënësit e klasës VIII-B, të cilët kanë firmosur një pyetësor dhe kanë mohuar pretendimin e znj. A.B, se znj. I.M. ka qenë prezent në këtë klasë dhe ka ndërhyrë në detyrat e znj. B. Në këtë mënyrë znj. B ka krijuar një situatë të vështirë me debatin që ka kryer me znj. I.M. gjatë ushtrimit të detyrës, gjë e cila ka cënuar integritetin e mësuesit. Në përfundim Komisioni i Disiplinës, duke analizuar provat e mbledhura nga Komisioni Etikës, pretendimet e znj. A.B, ka konstatuar se shkeljet në fjalë janë shkelje flagrante të Rregullores “*Për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, neni 34 dhe neni 56, pika “a” dhe “b”, pasi kemi të bëjmë me rast të përsëritur për të disatën herë, referuar edhe shkresës përcjellëse mbi raportin e vëzhgimit të përcjellë nga ZVA Tiranë me nr.2708 prot., datë 02.06.2020.

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1067 prot., datë 22.07.2020.

- b. Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Etikës së kësaj shkolle, datë 02.06.2020, lidhur me ankesën e paraqitur në MASR, në ZVA, si dhe në drejtorinë e shkollës, nga nxënësja e klasës së IX-A, E. Sh. si dhe prindërit e saj, ndaj mësueses A.B.

Në lidhje me këtë çështje, znj. H, sqaron se, prindi R. Sh. dhe vajza e saj E.Sh., nxënëse e klasës 9-A, në ankesën drejtuar MASR dhe ZVA Tiranë kanë parashtruar pakënaqësi në lidhje me vlerësimin e periudhës së dytë në lëndën e Gjeografisë, gjatë mësimit në distancë, për shkak të Covid-19, për mosargumentimin e vlerësimit, moskthim përgjigje dhe mosbërjen transparente të rezultateve të marra në detyrën përmbledhëse, duke rënduar kështu gjëndjen psikologjike të nxënëses, kjo e dokumentuar nga relacionet e psikologes së shkollës L. B. Komisioni i Disiplinës, pasi analizoi ankesën, pretendimet e mësueses e cila kundërshton çdo pretendim dhe komunikimit me sms dhe *WhatsApp*, vlerësoi se, mësuesja kishte vepruar në kundërshtim me Rregulloren “*Për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”, nenet 34 dhe 56, pikat “a” dhe “b”.

Bazuar në nenin 107, të rregullores së mësipërme, Komisioni i Disiplinës me votim të fshehtë vendosi me 7 vota pro, për dhënien e masës disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*” për mësuesen A.B

2. Gjatë procedurave të shqyrtimit, ankuesja informoi Komisionerin se, në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, asaj nuk i është dhënë ngarkesa mësimore sipas akteve ligjore në fuqi, ndryshe nga kolegët e saj që kanë kaluar dy herë grafikun e hartuar nga ana e drejtueses së shkollës.

Në lidhje me këtë situatë të re të parashtruar nga ankuesja, me shkresën nr. 774/1 prot., datë 09.09.2020, Komisioneri i’u drejtua znj.E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, duke i kërkuar informacion dhe dokumentacionin përkatës lidhur me procedurat e ndjekura për shpërndarjen e ngarkesës mësimore për ankuesen dhe mësuesit e tjerë.

Me shkresën nr.270 prot., datë 18.09.2020³, znj.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, dërgoi informacionin në lidhje me procedurat e ndjekura për shpërndarjen e ngarkesës mësimore për rastin e ankueses. Znj. H, informon se, sipas ngarkesës mësimore për të gjithë mësuesit e të gjithë profileve të Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, e cila është protokolluar në Zyrën Vendore Arsimore Tiranë me nr. 9378, datë 17.09.2020, ankuesja A.B ka një ngarkesë të plotë prej 20 orë javore mësimore dhe 2 orë kujdestari klasa 9.

3. Në vijim ankuesja depozitoi pranë Komisionerit informacion plotësues në lidhje me ankesën, i cili u administruan me nr.1270 prot., datë 21.09.2020. Në këtë informacion, ndër të tjera, ankuesja parashtron:

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 774/2 prot datë 21.09.2020.

Prej një periudhe 3 vjeçare nga ana e drejtoreshës së institucionit znj. E.H dhe grupi i mësueseve nëpërmjet të cilit ajo vepron, ushtrohet një dhunë verbale e vazhdueshme dhe diskriminim, i cili mbërrin deri në veprime të dënueshme si cënimi i privatësisë dhe kërcënim i hapur verbal në vendin e punës për t’u larguar. Arsyet reale të kësaj situatë aspekt normale në vendin e punës janë: së pari kërkesa verbale për favorizim me notë për nxënës të caktuar që janë të lidhur me këtë grup mësuesish dhe drejtoreshën dhe nëpërmjet prindërve të këtyre fëmijëve ushtrohet shantazh dhe presion dhe së dyti, mungesa e ngrakesës mësimore prej 3 vitesh e dy mësueseve të biokimisë L.A. dhe M.B. (anëtare të K. Etikës), ka bërë që drejtoresha prej 3 vitesh të ushtrojë dhunë dhe presion të vazhdueshëm, me qëllim që orë që i përkasin ekipit lëndor ku përshihet ankuesja, Histori-Gjeografi-Edukim Qytetar, t’i kalojnë këtyre dy mësueseve dhe ka krijuar situatë të pakëndshme midis kolegëve, kur detyra e institucionit arsimor është krijimi i një klime pozitive dhe bashkëpunuese në punë. Diskriminimi arriti kulmin me dhunën psikologjike dhe kërkesën verbale të mësuesve fillimisht dhe më pas të drejtoreshës për largimin tim dhe të fëmijëve nga ky institucion. Situata bëhet akoma më alarmante kur duke përdorur faktin se këta mësues janë anëtarë të organizmave brenda institucionit, apo drejtoresha duke përdorur pozicionin që ka, keqpërdorin nxënës apo prindër, me të cilët janë të lidhur apo më keq psikologjen e shkollës, e cila ka qëndruar tërësisht indiferente karshi ankesave të bëra si prind apo edhe si punonjëse e këtij institucioni.

Ankuesja shprehet se në ndarjen e ngarkesës mësimore pati sjellje diskriminuese nga ana e drejtoreshës, pasi iu refuzua dhënia e lëndës së historisë tek klasa kujdestari 9b, me pretekstin se bëheshin shumë 2 (dy) lëndë mësimore në klasën kujdestare, ndërkohë që kolege të tjerë kanë 2(dy) lëndë me klasën kujdestari, referuar orarit mësimor.

Ankuesja pretendon se qëndrimi i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes është jo korrekt. Ajo pranon se është thirrur në datat 12 dhe 14 shkurt 2020 dhe nuk është lejuar të vendosë shënimin e saj, pasi nuk mund të firmoste kur gjithçka që ishte shënuar ishte e pavërtetë. Ajo ka kërkuar një kopje të ankesës së depozituar kundër saj, por nuk i’u vendos në dispozicion. Në asnjë nga këto data nuk ka marrë pjesë asnjë prind. Për datën 17 shkurt 2020, ankuesja deklaroi se nuk ka marrë asnjë njoftim për mbledhje të Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, madje ka kërkuar me anë të një kërkesë me shkrim që ti vendosej në dispozicion kopja e ankesës, por është ofenduar nga anëtarja e Komisionit të Etikës znj. M. B. e cila i ka thënë “...mos do dhe një nuse”. Në lidhje me këtë moment ankuesja shprehet se është ankuar në drejtori dhe kjo kërkesë është nënshkruar nga drejtoresha e institucionit “dorëzoi mësuese A.B”. Ankuesja shprehet se sjellja e drejtoreshës për të mos ballafaquar situatën ishte tërësisht diskriminuese dhe në shkelje të legjislacionit të fuqi.

Me dy prej anëtarëve të Komisionit të Etikës, ka patur konflikt interesi, pasi në datën 14 shkurt 2020 është ankuar për mësuesen L. A. për dhunë verbale dhe kërcënim në vendin e punës në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, por duke i kërkuar edhe drejtoreshës mbajtjen e një qëndrimi, kurse ndaj mësueses M. B., ka depozituar ankesë në drejtorinë e shkollës në datë 17.02.2020. Në datë 13 shkurt 2020, katër mësueset, anëtare të Komisionit të Etikës, në orën e mësimin të fizikës kanë marrë firmat e fëmijëve 13 vjeç. Sjellja e psikologes së shkollës në këtë situatë ka qenë

tërësisht në shkelje të ligjit, pasi ajo nuk ka miratimin e asnjë prindi për të kryer çfarëdolloj komunikimi me fëmijët e klasës kujdestare të ankueses. Psikologjia gjithashtu ka shkelur legjislacionin në fuqi pasi nuk ka informuar ankuesen si mësuese kujdestare, në rastin kur psikologjia është gjetur nga ankuesja në klasë me nxënësen e klasës së saj kujdestare, S. Ç. dhe mësuesen lëndore I. M.

Në lidhje me një ankesë të bërë në vitin 2017 kundër mësueses S. Ç. për fyerje dhe shkelje të Kodit të Etikës, ankuesja shprehet se e depozitoi këtë ankesë pas insistimit të drejtoreshës së shkollës. Ankuesja e tërhoqi këtë ankesë pas insistimit të kolegëve dhe prindërve dhe në të mirë të punës dhe se kjo ankesë u shqyrtua tej afateve ligjore nga ana e drejtoreshës.

Ankuesja kundërshton pretendimin e drejtoreshës së shkollës znj. H dhe drejtoreshës së ZVA Tiranë, znj. E.A., se nuk është vënë në dijeni të qëndrimit të Komisionit të Etikës të datës 17.02.2020, pasi që pas kësaj date e deri në javën e dytë të muajit mars, ankuesja ka munguar në shkollë dhe për këtë arsye Komisioni i Disiplinës nuk ka proceduar. Prania e ankueses në punë gjatë kësaj periudhe provohet plotësisht nga kalimi i plotë i pagës për këtë periudhë; më datë 21 shkurt 2020 së bashku me nxënësit e klasave 8 dhe 7a, ka qenë e ftuar në Bashkinë Tiranë në ditën botërore të Guidave Turistike ku janë nderuar për projektin e realizuar nga ana e tyre “Tirana 100 vjet kryeqytet”; në datën 4 mars është zhvillur mbledhje me prindërit; regjistrat dhe orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe; regjistrimet e kamerave të shkollës; në datë 09 mars 2020 kryerja e dezhurnit me mësuesen H. Sh. dhe në datë 27 shkurt 2020 për problematikat e krijuara në punë me kërkesën e ankueses ka zhvilluar takim me drejtoreshën e ZVA Tiranë znj. E.A. Në datë 27 shkurt ankuesja ka depozituar në drejtori një deklaratë ku paraqitej shqetësimi se klasa kujdestare e mësueses I. M. ishte orientuar të sabotonte orën e gjeografisë, duke lejuar nxënësit të vijnë në mes të orës së mësimi apo duke u përpjekur të përdorin pije energjike apo celularë gjatë orës së mësimi. Të gjitha këto tregojnë prezencën në punë.

Në datën 26.05.2020, ankuesja deklaroi se është thirrur nga drejtuesja e institucionit arsimor në prani edhe të Nëndrejtoreshës A.S. Gjatë këtij takimi ankuesja shprehet se është shantazhuar dhe është aluduar se kishte vendosur nota 10 për nxënësit që nuk e meritonin dhe nuk kishte vendosur notën 10 për nxënësen E. Sh. Gjithashtu u akuzua se nuk i kishte kthyer përgjigje nxënëses E.Sh., ndërkohë që rezultoi plotësisht e provuar e kundërta. U pretendua edhe se nxënësit nuk ishin informuar mbi mënyrën e zhvillimit të detyrës. Të gjitha këto janë plotësisht të pabazuara dhe për këtë gjë janë paraqitur provat përkatëse. Edhe pretendimi se nxënëses E.Sh. i ishte ngrënë nota për tre vite rresht është i pabazuar pasi rezultati vjetor në lëndën e gjeografisë ka qenë 10. Në takimin e datës 26.05.2020 ankuesja ka kërkuar një takim për t’u ballafaquar me prindin dhe nxënësen, ndërsa drejtoresha i ka premtuar një takim në datën 01.06.2020, ku prindi do të kërkonte falje. Në datë 29.05.2020 ankuesja deklaroi se ka dorëzuar një dosje në lidhje me problematikën në ZVA Tiranë, por zyrtarisht nuk mori asnjëherë përgjigje.

Në datën 02.06.2020 deri në orën 14.00 ankuesja deklaroi se ka qenë në pritje së bashku me avokatët e saj të një komunikimi që do të bënte drejtoresha për një mbledhje të Komisionit të

Etikës, por pa patur informacion se për çfarë problematike. Në këtë orë pasi drejtoreshës i ka ardhur një komunikim nga ZVA Tiranë, i është komunikuar se në datën 03.06.2020 do të mbledhet Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës. Ditën e nesërme në orën 14.00 është komunikuar se Komisioni i Etikës ishte mbledhur pasditen e datës 02.06.2020, me pretendimin se është mbledhur për një ankesë të një prindi R. Sh. ndaj vajzës të së cilës ankuesja ka bërë vlerësim jo korrekt.

Ndërkohë që ankuesja priste që në datën 01.06.2020 të takonte prindërit e nxënëses E. Sh., sikurse i ishte komunikuar nga drejtoresha, kjo e fundit kishte dërguar prindin në ZVA Tiranë, për të bërë ankesë me pretendimin se ankuesja nuk kishte komunikuar me nxënësen/prindin.

Përveç konfliktit të interesit të dy prej anëtareve të Komisionit të Etikës, mësueset L. A. dhe M. B., ky komision ka mungesa pasi ka vetëm 4 firma mësuesish, në kundërshtim të plotë me ligjin që parashikon së paku 7 anëtarë. Me sjelljen e tij Komisioni i Etikës i Cili pretendon se është mbledhur në datë 02.06.2020 ka shkelur legjislacionin në fuqi, nuk ka thirrur palët në ballafaqim, nuk ka lejuar që ankuesja të dëgjohet, të mbrohet dhe të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të saj. Komisioni i Etikës është mbledhur në datë 02.06.2020 pa njoftim, në datë 03.06.2020 mbledhet e jep vendim pa dhënë mundësinë e mbrojtjes dhe paraqitjes së provave. Madje ky komision ka anëtarë të pazgjedhur si rasti i mësueses O. Sh. dhe ka mangësi në përbërje pasi mungojnë prindër, duke qënë kështu në kundërtim me ligjin.

Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës nuk kanë njoftuar Kryetarin e Bordit të Shkollës z. I. S., i cili është i habitur pasi në vlerësimin e tij ankuesja rezulton si një mësuese model. Në datën 29.06.2020, z. I. S. deklaroi se nuk ka asnjë informacion në lidhje me çështjen.

Sipas ankueses, nisur nga njoftimi i komunikuar nga ZVA Tiranë në datë 02.06.2020, duket se ka një koordinim midis drejtoreshës znj. H dhe drejtoreshës së ZVA Tiranë për një vendim të marrë më herët që në muajin shkurt 2020.

Në datë 29 maj 2020 ankuesja deklaroi se është njoftuar me email nga drejtoresha znj. H për të marrë në telefon prindin e nxënëses E. Sh., ndryshe do të merrej masë disiplinore. Pavarësisht se kjo ishte një kërkesë jo korrekte dhe jashtë orarit zyrtar të punës, për më tepër që takimi ballafaques me prindin e nxënëses ishte kërkuar nga ankuesja që në takimin e datës 26.05.2020 ankuesja përsëri ka kontaktuar me prindin e fëmijës. Gjatë komunikimit me prindin dhe nxënësen në *WhatsApp*, ankuesja shprehet se ndaj saj është përdorur një gjuhë provokuese, shantazhuese, kërcënuese dhe diskriminuese ndaj figurës së mësuesit. Ky qëndrim nuk u morr fare në konsideratë nga Komisioni i Etikës. Gjithashtu e papranueshme, fyese dhe provokuese është gjuha e përdorur nga nxënësjja E. Sh. në faqen e grupit në *WhatsApp* klasa 9a. Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës nuk morrën asnjë masë ndaj një komunikimi të tillë.

Ankuesja sjellë në krahasim qëndrimin e mbajtur nga drejtoresha e institucionit arsimor, karshi veprimeve në shkelje me ligjin të disa kolegëve dhe mosveprimeve në total të tyre: kërkesën e mësueses M. Sh., që u kërkon prindërve të japin deklaratë me shkrim ku u kërkon daljen jashtë

programit mësimor, veprim ky që sipas ligjit dënohet me largim nga puna; plotësimin e regjistrit me datë dhe temë në klasën 8b, viti shkollor 2019-2020, data 11 tetor nga mësuese I. M., kur ajo ka munguar për arsye shëndetësore, vlerësim me notë 4 të dy nxënësve E. T. dhe A. D., të klasës 8b, nga mësuese I. M. gjatë mësimin online periudha 2, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit; uljen e notës vjetore në lëndën fizikë për nxënësen A. Ç., klasa 8b, nga mësuese Sh. G. notat e nxënëses ishin 10, 9, 10, pra rezultati duhet të ishte 10. Edhe pse prindi u ankua, kjo nuk u morr parasysh nga drejtoresha e institucionit arsimor znj. H.

Akuesja pretendon se veprimet arbitrare të znj. H, kanë vazhduar edhe pasi viti mësimor 2019-2020 kishte përfunduar. Së bashku me Nëndrejtoreshën znj. A.S. dhe dy mësueset M. B. dhe L.A. është organizuar mbledhja e firmave të mësuesve për largimin e ankueses nga puna duke u munduar të përfshijnë edhe nxënësit që kishin mbaruar arsimin 9 vjeçar. Për këtë veprim, ankuesja deklaroi se është njoftuar me mesazh nga znj.A.D., prindi i fëmijës M. K. Nga komunikimi verbal me prindin, ky i fundit i ka komunikuar se në datë 28 qershor 2020, mësuese M.B, anëtare e Komisioni i Etikës i kishte kërkuar të firmoste për largimin e ankueses nga puna. Sipas ankueses, në datë 30.06.2020 prindit të fëmijës i kishin kërkuar llogari se pse e kishte njoftuar ankuesen. Menjëherë pas këtij takimi ankuesja deklaroi se është thirrur në zyrë nga drejtoresha znj. H dhe Nëndrejtoresha A. S. ku i është komunikuar se “për të mirën e saj” duhet të bënte kërkesë për lëvizje paralele, ndryshe do të dërgonte ankesa kundër ankueses duke përdorur kolegë, prindër dhe nxënësit. Po atë ditë znj. H i ka bërë vlerësimin vjetor të punës dhe i ka dërguar vazhdimisht mesazhe që të nxitoja të plotësoja dosjen për lëvizje paralele. Nën presion dosja u dorëzua të nesërmen por nuk u pranua pasi kishin kaluar afatet.

Referuar rezultatit vjetor të nxënëses E. Sh. për klasën e 9-të, lënda gjeografi është 10, ndryshe nga çfarë është përcjellë nga drejtoresha e institucionit znj. H që reklamoi 9, me qëllim krijimin e situatave të sajura dhe si një komplot i organizuar për largimin e ankueses nga puna.

Qëndrimi i drejtoreshës nuk ka ndryshuar dhe me mbarimin e lejes zyrtare gjatë verës së vitit 2020 ajo nuk pranoi që ankuesja të paraqitej në punë, madje në datë 02.09.2020 i ka kërkuar verbalisht të griste kërkesën për të marrë ngarkesën mësimore dhe të kërkonte në ZVA Tiranë që t'i jepeshin orë mësimore diku tjetër. Ankuesja deklaroi se ka bërë kallëzim në prokurori dhe ankesë me email në Ministrinë e Arsimit, dhe vetëm pas emailit i është dhënë ngarkesa mësimore

Ankuesja thekson se, raporti i vëzhgimit i ZVA Tiranë është keqinterpretuar nga drejtoresha e institucionit arsimor. Ndaj mësueseve që përmenden në raport për problematika madhore si, kurse private, shitja e notave, nuk mbahet asnjë qëndrim.

4. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁴ dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr.774/3 prot., datë 23.09.2020, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore publike në datën

⁴ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar : “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

06.10.2020. Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e të dy palëve të përfshira në procedurën administrative, të ankueses A.B, dhe E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, të cilat ishin presonalisht prezent.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja dha shpjegime në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë duke iu përmbajtur të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me Komisionerin.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ankuesja, znj. H parashtroi :

Ngarkesa mësimore është përgjegjësi e drejtorisë së shkollës. Gjatë 3 vitet e fundit 2018, 2019 2020, si dhe aktualisht ngarkesa mësimore është e plotë 20 orë mësimore (histori, gjeografi dhe 2 orë qytetari). Kjo është lehtësisht e provueshme pasi ngarkesa mësimore dorëzohet në Zyrën Vendore Arsimore dhe pasqyrohet në orar dhe regjistër. Orët e tjera të kësaj fushe plotësohen me Zyrën Arsimore nga mësuesit e tjerë definitiv. Ankuesja 3 vitet e fundit ka patur ngarkesë të plotë mësimore edhe këtë vit ka po këtë ngarkesë, konkretisht 17 orë gjeografi, 2 orë histori dhe 1 orë qytetari, pra 20 orë të plota. Asnjëherë dhe për asnjë moment nuk është tentuar zbritje ose marrje orësh nga departamentet e tjerë. Çdo mësues merr fillimisht orët e profilit të vet ose të përafërt. Në Departamentin e Histori-Gjeografisë, mësueset e këtij departamenti janë plotësuar me 20 orë mësimore të plota në vazhdimësi.

Znj. H, e kundërshton pretendimin se janë bërë debate për orët mësimore, pasi historinë dhe gjeografinë nuk mund ta japë asnjë mësues i lëndëve të tjera, pasi është profil i veçantë që e japin vetëm këto mësuese dhe askush tjetër. Në lidhje me faktin nëse ka patur ankesa nga mësuesja për zbritje orësh, znj. H deklaroi se, ankesa për ngarkesën mësimore janë bërë vetëm me një mesazh për ngarkesën mësimore të këtij viti, por kjo ngarkesë është shpërndarë dhe është e plotë dhe të gjithë janë njoftuar. Në lidhje me faktin se nuk është zhvilluar një takim, znj. H shpjegoi se për shkak të situatës së Covid 19 është synuar të ruhet distancimi dhe ndarja e orëve është bërë në takim me drejtoreshën, nëndrejtoreshën dhe departamentet përkatëse. Znj. H deklaroi se ka 3 deklarata të firmosura nga mësueset A.B, H. Sh. dhe nëndrejtoresha A. S. për marrjen e ngarkesës mësimore, e cila iu është dhënë mësueseve paralelisht dhe është e dokumentuar. Pra, departamenti e ka firmosur në të njëjtën ditë ndarjen e ngarkesës mësimore dhe nuk ka patur asnjë lloj debati ose ankese. Sa më sipër çdo lloj pretendimi në lidhje me ankesën është e pabazuar.

Në lidhje me pretendimet e ankueses se ndihet e shqetësuar në vendin e punës nga kolegët dhe si janë trajtuar ankesat që ankuesja pretendon se ka bërë në drejtim të saj, znj. H, deklaroi se, verbalisht dhe pastaj me shkrim ankuesja kishte bërë ankesë për mësuesen S. Ç., të cilën dëshiroja ta zgjidhja si në kolektiv me ballafaqim, duke diskutuar dhe me mirëkuptim, duke marrë mendimin e të gjithëve me qëllim zgjidhjen e situatës. Mësuesi në një moment të caktuar duhet të bëjë një kompleksitet veprimesh dhe gjatë kësaj kohe mund të ndodhin edhe gabime ose situata, për të cilat puna e parë është biseda, ballafaqimi në mënyrë që të zgjidhen. Ankesa është dërguar në K. Etikës ku janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Znj. H thekson se, nga ana e saj nuk ka patur asnjë ngrirje. Përpara muajit janar, shkurt të këtij viti, ajo shprehet se nuk ka patur ankesa. Ka patur gjithmonë këshillime dhe dashamirësi që situatat të zgjidhen me qetësi dhe qytetari. Në shkollë nuk është fryma që pretendohet dhe mësueset janë të përgatitura. Në lidhje me pretendimet për problematika me mësueset e biologjisë /kimisë, znj. H shprehet se janë të pabaza, por edhe nëse ka janë problematika të lehta dhe që zgjidhen dhe nuk është e vërtetë që nuk është gjetur gjuhën. Në pothuajse 3 vjet janë zhvilluar rreth 40 seanca dëgjimore/këshilluese. Në 2018 edhe pse ankuesja shprehet se pati një ngrirje të marrëdhënieve, znj. H thekson se ajo solli 2 fëmijët e saj në shkollë të cilët u mirëpritën. Përderisa sjell fëmijët do të thotë se e vlerëson shkollën për sa kohë i beson këtij institucioni fëmijët e tu.

Në lidhje me pretendimin për zhdukjen e planeve mësimore vitin e kaluar (2019), znj. H sqaron se ato nuk janë zhdukur në asnjë moment. Planet mësimore kanë qenë aty, janë marrë në shqyrtim dhe me firmë, madje edhe aktualisht janë në dosje dhe ajo kishte firmosur se planet kanë qenë aty.

Znj. H thekson se, kalimi i ankesës jo te drejtori i shkollës, por direkt tek Drejtorja Arsimore e rëndon situatën, pasi duket sikur nuk ekziston forca në shkollë për ta zgjidhur problematikën që paraqitet. Në vijim znj. H ndalet tek një ankesë që znj. B ka bërë ndaj mësueses së frëngjishtes duke e paraqitur ankesën kundër kësaj mësuese direkt tek Drejtorja Arsimore dhe duke mos vënë në dijeni drejtuesen e shkollës. Nëse ka ndonjë gjë që nuk shkon, ulemi e diskutojmë me mësueset. Pse duhet të shkojë direkt ankesa atje lart? Ankesa patjetër që duhet bërë, por të zbatohet edhe ne hapat, të gjejmë fuqinë për t'i zgjidhur. Në fillim të vitit shkollor 2019 rreth datës 02 tetor, znj. H deklaroi se është bërë një ankesë ndaj mësueses së gjeografisë në Drejtorinë Arsimore, lidhur me një situatë të krijuar në klasë. Përsëri ankesa është drejtuar tek Drejtorja Arsimore dhe nuk është paraqitur asnjë ankesë verbale ose e shkruar në shkollë. Znj. H, informon se është njoftuar gjatë kohës që kanë qenë në varrimin e një kolegu se bashkëshorti i ankueses kishte paraqitur ankesë, ankesa të cilat nuk ishin paraqitur as verbalisht më parë tek ajo. Znj. H shprehet se e ka thirrur mësuesen dhe i ka deklaruar se nëse ka diçka, ishte e gatshme ta dëgjonte që ta zgjidhnin dhe ti sheshonin gjërat, pasi produkti final i shkollës është nxënësi dhe situata të tilla dëmtojnë cilësinë e mësimdhënies, komunikimin dhe është detyrë e drejtorisë që të krijojë një situatë sa më të qetë.

Në lidhje me pretendimin për lejen pa të drejtë page, znj. H sqaroi se, ajo është kompetencë e drejtueses së shkollës. Ankuesja kishte depozituar dokumentacionin dhe ajo kishte miratuar lejen duke e firmosur dhe nëshkruar atë. Nga ana e saj nuk ka patur asnjë problematikë në lidhje me lejen, por shprehet se nuk ka dijeni në lidhje me pretendimet që mund të jenë ngritur nga drejtuesja e Drejtorisë Arsimore.

Në lidhje me situatën e krijuar me mesazhet dhe ku pretendohet se janë të përfshira mësuese Sh. G. dhe L.M., znj. H sqaroi se këto mësuese i kanë parashtruar me shkrim që në asnjë moment nuk kanë përdorur nxënësit. Gjithashtu ka një dokument me shkrim të lëshuar nga prindi i fëmijës, i cili deklaroi se i ishte prishur telefoni dhe ka marrë një telefon të ri. Pra, nuk ka asnjë tentativë nga ana e mësueseve, pasi vetë prindi e konfirmon prishjen e telefonit. Në bazë të thënieve të

prindit, fëmijës dhe relacionit të psikologes, mësueset nuk kanë përdorur nxënësit për mesazhe. Znj. H sqaron se nuk ka marrë asnjë ankesë me shkrim nga ana e ankueses, përveç një *emaili* të ardhur më datë 27 ose 28 janar, 2020. Të gjitha gjërat e mëparshme kanë qenë verbale. Më vonë mësuesja ka bërë takim me prindër dhe e ka sqaruar në një mbledhje.

Në lidhje me ankesën që është bërë në 14.02.2020, Komisioni Etikës, ky i fundit ka marrë ankesën e një mësuese në fillim të shkurtit. Komisioni i Etikës ka bërë seancat e veta gjatë periudhës së shkurtit të gjitha të dokumentuara sipas procesverbaleve përkatëse ku ka qenë prezent edhe mësuese A. Komisioni i Etikës ka ardhur me një propozim për Komisionin e Disiplinës. Drejtori nuk është pjesë e Komisionit të Etikës, por vetëm në Komisionin e Disiplinës. Pra, nuk ka qenë ankesa e bërë kundër drejtueses në datë 14 shkurt, sepse situatat kanë qenë të mëparshme. Znj. H sqaroi se të vetmet ditë që ankuesja ka munguar pas datës 14 shkurt, kanë qenë 2 ose 4 ditë, kur ajo ka qenë me raport dhe se nuk ka qenë pretendim i saj se ankuesja kishte munguar. Mësuese A, ka qenë pjesë e guidave turistike dhe kanë marrë edhe çmimin. Projektet e mësueses janë të ekspozuara në të tre katet e shkollës.

Sipas znj. H, janë bërë të gjitha njoftimet e datës 1 dhe 2 qershor dhe se e ka këshilluar mësuesen që t'i marrin gjërat me qetësi dhe ankesat t'i nisim nga aty ku punojmë çdo ditë. Më tej ajo informoi se gjatë muajit shkurt shkolla kishte patur një kontroll tërësor nga Drejtoria Rajonale Durrës dhe në fund të po këtij muaji nga Zyra Arsimore Tiranë. Në të dyja inspektimet nuk rezultoi që drejtoria e shkollës ka ndonjë qëndrim negativ ndaj ndokujt, nxënës, prindër ose mësues.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se ishte detyruar dhe i ishte kërkuar që të largonte fëmijët e saj nga shkolla, znj. H deklaroi se, ajo i kishte vlerësuar fëmijët e Anilës, se djali i ankueses F. B., ishte një fëmijë inteligjent, por që duhej të ishte i lirshëm që të shfaqte mendimin e tij lirshëm dhe pa u ndikuar. Ajo theksoi se nuk kishte arsye të parashtruar nga prindi për largimin e fëmijëve dhe fëmijët janë larguar mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga prindërit.

Znj. H, deklaroi se, në muajin shkurt 2020 është bërë një peticion nga mësuesit e shkollës, jo pak por 27 mësues nga 35 mësues gjithsej që ka shkolla. Ata i janë drejtuar ZVA Tiranë dhe drejtorisë së shkollës duke kërkuar që të rregullohej një situatë konfliktuale, e përsëritur dhe gjithmonë në mes ishte mësuese A, por gjithmonë pa asnjë lloj arsye. Mësuesit kanë kërkuar që gjatë mësimit të kishin qetësi, mirëkuptim dhe jo situata konfliktuale, pasi në këtë mënyrë çënohej cilësia e mësimit nëse në çdo moment do të krijoheshin situata të tilla. Sipas shpjegimeve të dhëna nga znj. H, 15 mësues që kanë firmosur peticionin ishin përfshirë gjatë viteve në konflikte me ankuesen për arsye të ndryshme, si rregjistrat, dezhurni, por jo që lidhen me fëmijët. Këto situata konfliktuale të pabaza nuk duhet të jenë më pasi marrin kohë dhe prishin qetësinë dhe janë situata që mund të ishin zgjidhur duke diskutuar. Mësuesit e tjerë kanë qenë dëshmitarë, kanë qenë prezent dhe jo të përfshirë direkt në situatat konfliktuale që kanë ndodhur. Fundi i këtij peticioni ka qenë se, mësuesit ishin të gatshëm për të zgjidhur situatat por jo kur nuk ka baza. Znj. H thekson se në shkollë nuk shkojnë për të gjetur gabimet e njëri tjetrit por për të

dhënë mësim. Ankuesja prapësoi duke u shprehur se e gjithë kjo duket që është e organizuar, pasi ajo nuk ka asnjë lidhje ose marrëdhënie me mësues të ciklit të ulët.

Në lidhje me propozimin e bërë gjatë seancës dëgjimore për mundësinë e arritjes së një marrëveshje pajtimi dhe zgjidhjen e kërkesave të parashtruara në ankesë, znj. H u shpreh se vendimi për masën disiplinore ishte një vendim i Komisionit të Disiplinës dhe nuk varej prej saj ndërsa në lidhje me ndërprerjen e sjelljeve diskriminuese në të ardhmen, ajo u shpreh se nuk ka patur asnjëherë sjellje diskriminuese nga ana e saj dhe situatat janë krijuar si pasojë e keqkuptimeve.

Në datë 17.02.2020, Komisioni i Disiplinës ka marrë një propozim nga Komisioni i Etikës për marrje të masës disiplinore ndaj mësuese A, e paraprirë nga takime në vitet e mëparshme. Ky propozim ka ardhur pasi Komisionit të Etikës, i ishte referuar një ankesë nga mësuese I. Sh. Komisioni i Etikës pasi e ka shqyrtuar rastin, ka bërë ballafaqimet dhe ka arritur në konkluzionin dhe ka propozuar marrjen e masës disiplinore. Në kushte normale, Komisioni i Disiplinës do ta kishte shqyrtuar para mbylljes së shkaktuar nga Covid 19. Për shkak të mungesës gjatë javës së parë të marsit të mësuese A, shqyrtimi u shty me rikthimin në shkollë në datë 01 ose 2 qershor.

Në Komisionin e Etikës referuar dokumentacionit të ardhur nga DAR Tiranë është dorëzuar një ankesë e paraqitur nga prindi i një nxënëse në klasën e 9-të. Sipas ankesës, prindi i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme mësueses vlerësimin për fëmijën e vet, por vlerësimi që ka marrë në fund të periudhës së dytë nuk përkonte me rezultatet, të cilat bëhen të qarta gjatë gjithë periudhës. Gjatë periudhës janar-mars, pretendohet se vlerësimet që janë dhënë dhe që dalin nga mesazhet kanë qenë të ndryshme nga ato që u nxorën në përfundim. Prindi ka ngritur pyetje se pse këto vlerësime kur ajo ishte informuar për të tjera vlerësime. Znj. H thekson se, me vlerësimin e ri nota nuk duhet të jetë surprizë për prindin dhe fëmijën. Prindi pretendoi se, për 5 ditë rresht i ka kërkuar mësueses vlerësimin me telefon dhe mesazhe dhe nuk ka marrë përgjigje. Më vonë i ka dhënë vlerësimin, por nxënësja ka kundërshtuar duke pretenduar se ka marrë të tjera nota dhe po njihej me të tjera nota duke referuar në komunikimin në *WhatsApp*.

Në datë 26 maj 2020 znj. H deklaroi se në lidhje me ankesën e prindit ka bërë një takim me ankuesen, gjatë të cilit është mbajtur procesverbali i firmosur edhe prej saj. Gjatë këtij takimi u ra dakort që mësuesja do ta diskutonte me prindin, do ta qetësonte, sepse nxënësja i ishte drejtuar psikologes së shkollës pasi ndihej shumë e shqetësuar për shkak të situatës. Prindi ka bërë ankesë edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Zyrën Vendore Arsimore.

Në lidhje me pyetjen e drejtuar gjatë seancës, nëse kishte patur pretendime të të njëjtës natyrë nga prindër/nxënës ndaj ankueses ose mësuesve të tjerë, znj. H u shpreh se nuk ka patur ankesa të tilla të depozituara.

Znj. H, theksoi se, pretendimi i prindit nuk ishte për notën por për lënien mënjane, për mossqarimin dhe për këtë i vendosi në dispozicion thirrje telefonike dhe mesazhe dërguar mësueses. Prindi dhe nxënësja kanë depozituar me shkrim sqarime se kanë marrë telefonatë nga

mësuese A, por kjo e fundit nuk i ka qetësuar por i ka shqetësuar dhe ajo që ata kërkonin ishte qetësia. Znj. H sqaron se nuk është detyrë e mësuesit kujdestar të japi notat, por e mësuesit lëndor që duhet të sqarojë dhe të argumentojë dhe pretendimi qëndron se nota nuk është argumentuar. Mësuesja kishte për detyrë që të telefononte prindin dhe nxënësin dhe të zhvillonte një bisedë të qetë dhe të argumentuar.

Znj. H hodhi poshtë pretendimet e ankueses se ajo i ka kërkuar asaj që të bënte lëvizje paralele dhe i ka bërë vlerësimin e performancës, pasi sipas udhëzimit ai është pjesë e aplikimit por në asnjë moment nuk i ka imponuar që të bënte lëvizje paralele.

Në lidhje me kërkesën për të dhënë sqarime në lidhje me shkakun tjetër të diskriminimit të pretenduar atë të “gjendjes arsimore”, ankuesja sqaroi se ky pretendim i saj konsistonte në faktin se ka dëgjuar më shumë se një herë fjalë se ajo synon që të zërë vendin e drejtoreshës pasi ka më shumë kualifikime se ajo. Ankuesja hedh poshtë këto pretendime që qarkullojnë ndër vite pasi nuk ka qenë asnjëherë e interesuar, ndërsa znj. H u shpreh se nuk ka dëgjuar të tilla pretendime.

Ankuesja u shpreh se, rezultatet e tremujorit të dytë dhe notat përkatëse pasqyrohen në regjistër dhe se gjatë tremujorit të parë nxënësja e cila pretendon se është ekselente në test ka marrë notën 8. Për më tepër nota përfundimtare del në qershor dhe nuk ka se si ti garantojë prindit dhe nxënësit që në muajin maj, dhe t'i qetësojë se nota do të ishte 10. Bazuar në udhëzimin e ministrisë për vlerësimin në distancë të nxënësve, ankuesja u shpreh se nxënësës në fjalë sikurse të gjithë nxënësve iu shtua një notë dhe nota përfundimtare, për këtë nxënëse e nxjerrë në muajin qershor është 10.

Ankuesja shpjegon se pretendimet e nxënësës dhe prindit të saj kanë qenë se në detyrën e muajit prill 2020 ajo duhet të ishte vlerësuar me notën 10. E pyetur në lidhje me procedurën se si veprohej në rastet kur prindër ose nxënës kishin kundërshtime në lidhje me vlerësimin e një detyre, znj. H sqaroi se, faza e parë ishte që detyra i kthehej për rishikim mësuesit dhe kur vlerësimi nuk ndryshonte pas rishikimit ngrihej një komision, por ajo theksoi se nuk ishte ky rasti. Në vijim ajo sqaroi se, nota zyrtare për nxënësin do të ishte nota e vendosur nga komisioni dhe që nuk kishte asnjë penalizim ose masë për mësuesin. Në rastin në shqyrtim, znj. H sqaroi se ky komision nuk u ngrit pasi mësuesja do ta rishikonte, pasi kështu ishte dakortësuar në takimin e datës 26 maj 2020. Nga mësuesja u kërkuar të argumentonte notën.

- Në vijim të seancës dëgjimore, palët kanë depozituar pranë Komisionerit informacione shtesë. Konkretisht, me shkresën nr.774/4 prot., datë 08.10.2020 janë administruar aktet e depozituara nga ankuesja ndërsa me shkresën nr. 882/1 prot datë 14.10.2021, janë administruar aktet e depozituara nga subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa. Shpjegimet dhe aktet e depozituara sikurse rezultoi nga verifikimi janë depozituar nga palët nëpërmjet komunikimeve të mëparshme.

- Me shkresën nr.1499 prot., datë 02.11.2020, ankuesja ka depozituar informacion plotësues nëpërmjet të cilit pretendon se qëndrimi i mbajtur ndaj dy fëmijëve të saj F. B. dhe A. B. ka qenë diskriminues, të cilat datojnë që prej vitit 2018 deri në momentin e largimit të fëmijëve nga shkolla, dhe ku pretendohet se përfshihen disa mësues, por edhe znj. H, e cila nuk ka marrë asnjë masë për zgjidhjen e ankesave të bëra në lidhje me fëmijët e ankueses.
- Me shkresën nr.1595 prot., datë 18.11.2021, ankuesja ka depozituar një tjetër informacion plotësues në lidhje me pretendimet e saj. Ndër të tjera, ankuesja pretendon se, znj. H, anëtarët e Komisionit të Etikës dhe psikologja e shkollës, për të përligjur pohimin e rremë të mësueses I. M. (e cila ka depozituar ankesën kundër ankueses në shkurt 2020), se kjo mësuese nuk kishte qenë në klasë kur ishte zhvilluar pyetësori me klasën 8b (klasë e cila është në kujdestari të ankueses), kanë marrë gjatë orës së fizikës (të zhvilluar nga mësuese Sh. G.) firmat e nxënësve të kësaj klase. Këto firma të nxënësve janë marrë me pretendimin se duhet të firmosnin ata fëmijë, të cilët kishin marrë pjesë në anketimin e zhvilluar disa ditë përpara. Sipas ankueses, kjo përbën shkelje të rëndë ligjore, pasi: - është çenuar ora mësimore, pasi në orën e fizikës në prani të psikologes dhe 4 mësueseve të Komisionit të Etikës janë marrë firmat e nxënësve;- anketimi është zhvilluar nga psikologja pa lejen me shkrim të prindit ose kujdestarit ligjor të fëmijës;- janë manipuluar fëmijët nga psikologja dhe sipas pohimeve janë marrë fëmijët veçmas nga psikologja disa herë; - nuk ka bashkëpunuar, komunikuar dhe relatuar me mësuesen kujdestare, që në rastin konkret është ankuesja; - psikologja ka relatuar në drejtori raporte të rreme për ankuesen dhe ka relatime pa datë. Ankuesja thekson se në raportin e ZVA Tiranë ajo nuk është relatuar në asnjë rast negativisht nga nxënësit ndërkohë që janë përmendur mësues të tjerë. Sa më sipër ankuesja pretendon se janë çenuar rëndë të drejtat e minoreneve, pasi firmat e fëmijëve në raportin e rremë janë depozituar si provë në gjykatë pa lejen e prindërve dhe se dokumentacioni mban vulën e drejtorisë së institucionit arsimor.
- Ankuesja në vijim ka paraqitur një informacion shtesë i cili është administruar pranë Komisionerit me nr.1766 prot., datë 16.12.2020, ku informon se, lidhur me problematikën e marrjes së firmave dhe paraqitjen e tyre në gjykatë Kryetari i Këshillit të prindërve të klasës kujdestari të ankueses, i ka kërkuar të takohet me znj. H dhe psikologjen e shkollës, për të verifikuar nëse janë çenuar interesat e nxënësve. Njëkohësisht ankuesja informoi se kishte paraqitur ankesë pranë Urdhrit të Psikologut, kundër psikologes së shkollës znj. L. B.
- Nga aktet e administruara rezultoi se ankuesja ka depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë një kërkesë padi për kundërshtimin e masës disiplinore dhe ka paraqitur gjithashtu një ankesë kundër psikologes së shkollës pranë Urdhrit të Psikologut. Në kushtet kur të njëjtat pretendime, që lidhen me ligjshmërinë e masës disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*” si dhe mbi rregullshmërinë e procedurave të ndjekura, që janë parashtruar pranë Komisionerit, ishin në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë si dhe duke mbajtur në konsideratë që ankuesja ishte paraqitur ankesë përpara Urdhrit të Psikologut,

kundër psikologes së shkollës, me vendimin nr.3, datë 11.01.2021, Komisioneri vendosi pezullimin e procedurës administrative, lidhur me shqyrtimin e ankesës, deri në marrjen e një vendimi nga ana e gjykatës në lidhje me kërkesë padinë e paraqitur nga ankuesja kundër Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë si dhe marrjen e një vendimi nga ana e Urdhrit të Psikologut në lidhje me ankesën e paraqitur nga ankuesja kundër psikologes L. B.

- Me shkresën nr. 100/1 prot. datë 03.03.2021, ankuesja depozitoi pranë Komisionerit vendimin nr. 241, datë 02.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, i cili ka vendosur: *“Pranimin e kërkesë padisë së paditëses A. B. Shfuqizimin e aktit administrativ, vendim nr. ska, datë 03.06.2020 të Komisionit Disiplinor të Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, si i pabazuar në prova e në ligj dhe detyrimin e palës së paditur të heqë nga doja e personelit këtë masë disiplinore”*.
- Me shkresën nr. 100/2 prot., datë 10.06.2021, ankuesja depozitoi pranë Komisionerit vendimin nr.1, datë 16.02.2021 të Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Profesional të Urdhrit të Psikologut, i cili ka rrëzuar ankesën e ankueses, pasi nuk plotëson kriteret ligjore për të kërkuar procedim disiplinor ndaj psikologes L.B., si dhe korrespondencën e mbajtur me Urdhrin e Psikologut. Nëpërmjet kësaj shkrese, ankuesja ka paraqitur edhe një shtojcë në ankesë, duke kërkuar shtimin si subjekte ndaj të cilëve drejtohet ankesa edhe 4 anëtarët e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe mësueset e Komisionit të Disiplinës. Ankuesja pretendon se është diskriminuar nga: - mësuese A.L. për shkak të gjendjes arsimore, bindjeve fetare të ndryshme, përgjegjësisë prindërore dhe përfshirjes në ankesën depozituar pranë ZVAT për shqetësime të vazhdueshme ndaj djalit të saj; - mësuese E.R., për shkak të bindjeve fetare dhe përgjegjësisë prindërore; mësuese M. Sh., për shkak të gjendjes arsimore më të lartë, bindjeve fetare, moshës më të re; - mësuese A.K., për shkak të bindjeve fetare, moshës së re dhe angazhimit personal për të përmbushur qëllimin e drejtoreshës së institucionit për largimin nga puna; - mësueset L.A. dhe M. B., për shkak të gjendjes arsimore më të lartë, bindjeve fetare të ndryshme, moshës së re dhe përfshirjes së tyre në ankesën drejtuar pranë MASR dhe ZVAT.
- Me shkresën nr.1012 prot, datë 01.07.2021, Komisioneri njoftoi palët për rifillimin e procedurës për shqyrtimin e ankesës. Në vijim me shkresën nr. 370 prot., datë 05.07.2021⁵, znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria” vendosi në dispozicion vendimin nr. 1, datë 16.02.2021, të Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor të Urdhrit të Psikologut si dhe kërkesën ankimore me nr.817 prot., datë 25.02.2021 të bërë nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë kundër vendimit nr. 241, datë 02.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Me shkresën nr. 1012/2 prot., datë 21.07.2021, ankuesja ka depozituar pranë Komisionerit parashtrimet e saj përfundimtare në lidhje me ankesën, duke parashtruar ndër të tjera:

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1012/1 prot., datë 06.07.2021.

Drejtoresha e këtij institucioni edhe pse kishte dijeni dhe kishte në disponim ankimin e kryer nga prindi, në kundërshtim flagrant me ligjin i ka mohuar të drejtën për t'u njohur me pretendimet kundrejt saj, duke cënuar rëndë parimin e kontradiktorialitetit si dhe barazinë e armëve në një procedurë të ndjekur ndaj saj. Kjo ka sjellë përpjekje të vazhdueshme për të marrë dijeni për ankesën, por është përcjellë nga zyra e drejtorisë e shoqëruar me fjalë fyese dhe nota shantazhi, duke dashur të influencojë pa të drejtë në vendimarrjen e ankueses në vlerësimin e nxënësës E. Sh.

Në procesverbalin e mbajtur nuk u shënuan fjalët e ankueses, por vetëm ato të drejtoreshës dhe pavarësisht kërkesës, ankueses nuk iu vendos në dispozicion kopja e procesverbalit. Kjo dëshmon synimin e drejtoreshës së institucionit për të mos marrë parasysh qëndrimet e saj, duke dashur të fshehtë argumentet të shoqëruara me prova si dhe duke shtrembëruar të vërtetën objektive, situatë e cila e vendos ankuesen në pozitë të disfavorshme. Në kundërshtim flagrant dhe të hapur me ligjin drejtoresha e institucionit ka favorizuar palën tjetër, duke marrë si të mirëqena të gjitha pohimet e kësaj pale pa bërë ballafaqimin e fakteve dhe pretendimeve të të dy palëve. Në këtë mënyrë drejtuesja ka paragjykuar rastin dhe ka arritur të konstitujë një Komision aspak legjitim dhe që prodhon vendime absolutisht të pavlefshme.

Lidhur me referimin për Raportin e Vëzhgimit me nr. 2708, datë 02.06.2020, ku pretendohet se pasi ka shqyrtuar ankesën e znj. B ndaj drejtueses së Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, ka dalë në konkluzionin se në shkollë është krijuar një frymë jo pozitive, ku shkaktar kryesor është A.B, ankuesja prapëson se, së pari, Komisioni i Disiplinës ka tjetërsuar tërësisht aktin e sjellë nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë, pasi ky raport në konkluzion i ka kërkuar dhe tërhequr vëmendjen drejtueses së shkollës që të punohet më shumë për të krijuar një klimë pozitive midis mësuesve. Ndërkohë, drejtuesja vepron në këtë mënyrë, duke ngritur menjëherë Komisione Disipline, me qëllim krijimin e tensioneve midis kolegëve, anatemimin për mësuesen A.B dhe propozimin e vendimarrjeve të tilla.

Ky raport vëzhgimi është vënë në dispozicion të ankueses në momentin e shqyrtimit përgjatë Komisionit të Disiplinës më datë 03.06.2020, ndërkohë që kishte qenë e parashikuar që mbledhja të bëhej një ditë përpara më datë 02.06.2020 dhe shkaku i shtyrjes nuk u sqarua nga ana e drejtorisë. Në seancën e datës 03.06.2020, ankuesja konstatoi se më datë 02.06.2020 ishte mbledhur Komisioni i Etikës, lidhur me ankesën e nxënësës, kur ndërkohë ankuesja ka qenë në ambientet e shkollës në pritje të shkakut të shtyrjes së mbledhjes së Komisionit të Disiplinës, pa u vënë në dijeni për mbledhjen fiktive të realizuar në datë 02.06.2020, të Komisionit të Etikës.

Propozimi i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes datë 02.06.2020 rezulton të jetë në kushtet e pavlefshmërisë absolute, kjo e provuar me vendimin nr.241, datë 02.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky Komision është në kundërshtim me dispozitën urdhëruese të nenit 36, të urdhrit 31/2020 Rregullorë për IAP, ku parashikohet detyrimi që ky komision të zgjidhet çdo vit të ri shkollor, ku ndërkohë Komisioni rezulton i para tre viteve dhe në

përbërje të tij duhet të kishte minimumi 7 anëtarë, në shkolla me të paktën 24 klasa. Komisioni i Sjelljes dhe Etikës ka patur në përbërjen e tij vetëm 3 anëtarë dhe një sekretare, të gjithë mësues dhe asnjë pjesmarrës nga Këshilli i Prindërve apo nxënësve. Diskriminimi në këtë rast qëndron në faktin se ky Komision është ngritur nga drejtorja e shkollës dhe në përbërjen e tij, ka patur vetëm anëtarë të cilët kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit me ankuesen, për shkak të ankesave që ajo ka bërë lidhur me to. Ky është edhe shkak që ky Komision ngrihet në kushte shkelje flagrante dhe pa patur përmbajtje dhe argumenta të saktë e në përputhje me ligjin dhe propozon dhënien e masave të tilla disiplinore. Ekzistenca e një fakti të tillë tregon qartë moszbatimin e ligjit dhe procedurave të posaçme, duke e vendosur ankuesen para një komisioni të njëanshëm dhe jo transparent, vendimi i të cilit parashikohej të ishte negativ ndaj saj, që në momentin kur anëtarët kishin qëllime të mirëpërcaktuara ndaj ankueses. Kjo ishte mundësia e tyre për të dhënë masë disiplinore që shkëpuste marrëdhëniet e punës së ankueses me institucionin arsimor.

Vendimi i Komisionit të Disiplinës është në shkelje të hapur me nenin 107 të Rregullores së datës 28.01.2020, i cili sanksionon se masa disiplinore duhet të jepet në mënyrë të përshkallëzuar. Parimi i përshkallëzimit në këtë rast, nëse do kishte një masë që duhej të vendosej sipas kushteve të rrethanave të çështjes, duhej të kishte nisur me qortim dhe jo me “paralajmërim për largim nga puna”. Dhënia e kësaj mase disiplinore, e cila është shfuqizuar nga gjykata dhe mundësia për të respektuar parimin e përshkallëzimit nuk kërkonte njohuri të specializuara ligjore, për shkak se qëllimi i dispozitës kuptohet lehtë me një interpretim të thjeshtë literal, sipas të cilit masat disiplinore jepen sipas radhës, por kjo tregon qëllimin e paracaktuar të drejtoreshës si drejtuese e Komisionit të Disiplinës, për të disfavorizuar dhe në një të ardhme të afërt të arrinte të shkëpuste marrëdhënien e punës së ankueses.

Në të gjitha rastet kur ankuesja është gjendur para diskutimeve me disa kolegë të tjerë, të cilët kanë përdorur fjalë fyese dhe kërcënuese ndaj saj, gjë për të cilën ka vënë në dijeni drejtuesen e shkollës, e cila ka për detyrë të nxisë frymën e bashkëpunimit mes kolegëve dhe trajtimin në mënyrë të barabartë, në rastin e ankueses është filluar procedura për marrjen e masave disiplinore dhe janë fshirë të gjitha komunikimet që ajo ka dërguar me mjete elektronike, duke i relatuar situatat e ndryshme të krijuara mes ankueses dhe kolegëve. Të gjitha këto forma diskriminimi, procedura të disfavorshme dhe akuza të pabazuara kanë cënuar rëndë integritetin, figurën dhe personalitetin si njeri dhe si mësuese e këtij institucioni, si dhe kanë sjellë si rezultat një frymë dhe mjedis jo pozitiv ndaj ankueses duke e bërë viktimë të pretendimeve absurde.

Ankuesja shprehet se nuk mund të përcaktojë me saktësi tendencën e drejtueses së institucionit për ta vënë përpara situatave të tilla, por bazuar në nenin 1, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet si diskriminim edhe “çdo shkak tjetër” duke i përcaktuar rastet e diskriminimit në mënyrë joshteruese. Nga data e pezullimit të procedurës administrative të shqyrtimit të ankesës situata ka qenë e njëjtë nga ana e drejtueses së institucionit arsimor, duke e diskriminuar vazhdimisht, e duke mbajtur një qëndrim jo korrekt në marrëdhënien e punës. Për gjithë sa më sipër, ankuesja parashtron se ndodhet para diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe viktimizimit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja është mësuese e lëndës Histori-Gjeografi, në Shkollën 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, emëruar në këtë pozicion pune me vendimin nr. 29, datë 04.12.2015, të drejtueses së këtij institucioni arsimor. Me vendimin e datës 03.06.2020, nr.s’ka, të Komisionit të Disiplinës së Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria”, ndaj ankueses A.B është dhënë masa disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”.

Ankuesja ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se, gjatë tre viteve të fundit pranë kësaj shkolle ka përjetuar shqetësime të vazhdueshme që lidhen kryesisht me marrëdhëniet e punës me kolegët dhe me drejtuesen e institucionit arsimor, por situata e diskriminimit ka precipituar, pas një ankese të bërë nga ana e saj në datë 14.02.2020, pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë (ZVAT) në drejtim të drejtoreshës së institucionit znj. E.H. Kjo ankese sipas ankueses, ka sjellë për pasojë dhënien e masës disiplinore të padrejtë, në kundërshtim të hapur me parimet themelore të Kodit të Punës, Kodit të Procedurave Administrative dhe rregulloreve që normojnë procesin mësimor në institucionet parauniversitare.

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se me vendimin e datës 03.06.2020, Komisioni i Disiplinës ka arritur në përfundimin se ndaj ankueses duhet të jepet masa disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*” pasi mori në shqyrtim dy vendime të Komisionit të Etikës së kësaj shkolle dhe konkretisht vendimin e datës 17.02.2020, lidhur me ankesën e mësueses I. M. ndaj ankueses dhe vendimin e datës 02.06.2020, lidhur me ankesën e paraqitur në MASR, ZVA Tiranë, si dhe në drejtorinë e shkollës, nga nxënësja e klasës së 9a, E. Sh. si dhe prindërit e saj ndaj ankueses.

Me vendimin e datës 17.02.2020, Komisioni i Etikës i ka përcjellë drejtores së shkollës për trajtim në Komisionin e Disiplinës rekomandimin e tyre për marrjen e masës disiplinore ndaj ankueses. Ky rekomandim ka ardhur pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga mësuese I. M. në datën 05.02.2020. Me anë të kësaj ankese mësuese I. M. ankohet ndaj mësueses A.B për sjellje jo etike. Mësuese I. M. pretendon se në datën 29.01.2020 është fyer dhe kërcënuar në vendin e punës nga A.B e cila në mëngjes pa filluar mësimi ka hyrë në sallë duke bërë titur dhe ulëritur, duke e akuzuar padrejhtësisht, me pretendimin se kishte qenë prezent në klasën 8 b, kur psikologjia zhvilloi pyetësorin me nxënësit e kësaj klase dhe më pas ka vazhduar me pretendime të paqëna për fshehje të regjistrave ditë më parë. Mësuese I. M. pretendon se ankuesja i është drejtuar duke thënë: “*Do ta shihni ju, do t’jua tregoj unë të gjithave*”.

Ankuesja pretendon se, në datën 23.01.2021, kur ajo ka patur dezhurnin sëbashku me mësuesen H. Sh., janë zhdukur dy regjistra dhe sipas saj këto regjistra ishin marrë nga mësuese I. M., e cila ndërkohë që ankuesja ishte duke i kërkuar, edhe pse ishte pyetur, nuk kishte treguar se regjistrat ishin marrë prej saj. Ngjarja në lidhje me rregjistrat është pasqyruar në procesverbalin e mbajtur nga dy mësueset që kishin dezhurnin, ankuesja dhe mësuese H. Sh.

Ndërsa në datën 28.01.2020, ankuesja pretendon se ka gjetur në ambientet e klasës së saj kujdestare 8b, nxënësen S. Ç., mësuesen I. M. dhe psikologun e shkollës. Ankuesja pretendon se për çdo problematikë duhet të diskutohet me mësuesen kujdestare që në rastin konkret është vetë ankuesja dhe se psikologjia nuk kishte asnjë autorizim nga prindërit e fëmijëve të kësaj klase. Në datën 29 janar 2020, në sallën e mësuesve, ankuesja deklaroi se i është drejtuar mësueses I. M. me fjalët: *“Pse ndërhysh në punët e klasës sime dhe në punën time (duke iu referuar punës së regjistrave) kur unë nuk përziej në punët e tua? Punët janë të ndara, ti në hapësirën tënde e unë në hapësirën time”* Sipas ankueses, në këtë moment ka ndërhyrë mësuesja A. L., duke thënë me zë të lartë : *“Ta heqim këtë mësuese”*.

Për shqyrtimin e kësaj ankese, Komisioni i Etikës ka kryer një takim në datën 12.02.2020, ku kanë marrë pjesë mësuese I. M. e cila ka paraqitur ankesë, ankuesja A.B si dhe katër anëtarë të Komisionit të Etikës L. A., A. K., M. B. dhe M. Sh. Ankuesja pranon që ka marrë pjesë në këtë takim, por ka refuzuar të vendosë firmën pasi në procesverbal nuk ishin pasqyruar saktë deklarimet e saj. Në vijim Komisioni i Etikës ka zhvilluar një takim në datën 14.02.2020, ku kanë qenë prezent mësuese I. M. që ka bërë ankesën, katër anëtarët e mësipërme të Komisionit të Etikës, psikologjia e shkollës, nxënësjja S. Ç. dhe ankuesja. Kjo e fundit edhe gjatë këtij takimi, ka refuzuar të firmosë me pretendimin se në procesverbal nuk pasqyrohen të sakta fjalët e saj. Referuar përmbajtjes së këtij procesverbali psikologjia dhe nxënësjja kanë deklaruar se mësuese I. M. ka dalë jashtë klasës kur është plotësuar pyetësori dhe nxënësjja ka vazhduar të plotësojë pyetësorin, pasi nxënësit e tjerë ishin larguar, pa ndërhyrjen e mësueses I. M.

Ndërkohë rezultoi se në datën 13.02.2020, Komisioni i Etikës, i përbërë nga mësueset L. A., A. K., M. B. dhe M. Sh., ka mbajtur një procesverbal ku kanë firmosur 26 nxënës të klasës së 8 b. Në këtë procesverbal pasqyrohet si vijon: *“Sot më datë 13.02.2020 gjatë pushimit të madh u zhvillua një sondazh me nxënësit e klasës së 8 b. Nxënësit u pyetën se gjatë zhvillimit të pyetësorit të bërë nga psikologjia e shkollës, kush mësues ishin prezent? Nxënësit pohuan se mësuesja I. M. doli jashtë klasës gjatë plotësimit të pyetësorit”*.

Përpara ngjarjes së datës 29.01.2020, rezultoi se ankuesja ka konstatuar konsumimin e pijeve energjike nga dy nxënës të klasës së saj kujdestare, konkretisht në datën 25.01.2020, një prej të cilëve nxënësjja S. Ç., dhe në datën 27.01.2020 e kishte trajtuar këtë problematikë në mbledhjen e klasës dhe këtyre nxënësve i'u ishte tërhequr vëmendja. Në datën 25.01.2021 ankuesja pretendon se në numrin e saj privat janë dërguar disa mesazhe jo etike nga numri i prindit të nxënëses S. Ç,

dhe në datën 27.01.2020, i ka kërkuar nxënëses që të sjellë prindin. Ankuesja pretendon se po në datën 27.01.2020, sms ishin fshirë nga numri dërgues dhe vetë numri nuk ekziston më.

Këto problematika, ankuesja i ka përmbledhur edhe në një *email* dërguar drejtoreshës në datën 29.01.2020, ku kërkon ndërmjetësimin e saj për zgjidhjen e situatës dhe ndërmjetësimin për të vendosur kontaktet me prindërit e nxënëses S .Ç. dhe se kjo problematikë i ishte bërë me dije që prej datës 27.01.2020. Për fshirjen e sms, ankuesja pretendon se janë përfshirë edhe mësueset Sh. G. dhe L. M. Gjatë seancës dëgjimore znj. H u shpreh se për problematikën e ngritura nga ankuesja ato ishin diskutuar në mbledhjen e klasës dhe se mësueset Sh. G. dhe L.M kishin lëshuar deklaratë se nuk kishin të bënin me peretendimet e ngritura, ndërsa kishte marrë nga prindi i nxënëses një deklaratë ku prindi ka deklaruar se i ishte prishur celulari dhe kishte marrë një celular të ri. Të gjitha këto sipas znj. H hedhin poshtë pretendimet e ankueses. Në cilësinë e provës është paraqitur vetëm një deklaratë me shkrim në formë ankese nga ana e mësueses Sh. G. e cila hedh poshtë pretendimin se ka fshirë *sms*, ndërsa nuk është depozituar ndonjë deklaratë nga prindi i nxënëses S. Ç.

Me anë të një kërkesë me shkrim në datën 17.02.2020, ankuesja ka kërkuar kopje të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, në datë 12 dhe 14 shkurt 2020, kopje të provave dhe të ankesës, si dhe informacion se çfarë ankete po zhvillohej me nxënësit e klasës së 8b në kujdestarinë e saj. Me anë të një deklaratë me shkrim të po kësaj date, ankuesja i është drejtuar znj.Hj, duke pretenduar se Komisioni i Etikës dhe Sjelljes nuk i kishte vendosur në dispozicion aktet, si dhe sjellje jo etike nga ana e një prej anëtareve të këtij komisioni. Konkretisht, sipas ankueses, mësuese M. B., i ishte drejtuar me fjalët “*Mos do edhe një nuse ti?*”, në lidhje me kërkesën për informacion që ajo i kishte drejtuar Komisionit të Etikës.

Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë nga mësuese I. M., Komisioni i Etikës, arriti në përfundimin se pretendimet e ankueses drejtuar mësueses I. M. ishin të pabazuara dhe një gjë e tillë u vërtetua nga 27 nxënësit e klasës së 8b, nxënëses S. Ç. dhe psikologes L. B. Komisioni i Etikës ka arritur në përfundimin se mësuese A.B kishte shkelur Kodin e Etikës së Mësuesit pasi: a. ka cënuar të drejtën për të kryer punën në kushte të sigurt për jetën dhe shëndetin, b. ka shkelur detyrimin që ka mësuesi që të trajtojë këdo në mjediset e IA me respekt, me dinjitet në mënyrë të kulturuar nga kushdo, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë, c. ka cënuar integritetin e mësuesve dhe, d. ka ushtruar presion dhe dhunë verbale në vendin e punës ndaj kolegëve. Për të gjitha këto shkelje të Kodit të Etikës së Mësuesit, Komisioni i Etikës me shkresën nr. 4 prot., datë 17.02.2020, i ka propozuar Komisionit të Disiplinës marrjen e masës disiplinore ndaj ankueses. Ky propozim i Komisionit të Etikës nuk rezultoi t’i jetë komunikuar ankueses. Ky propozim është marrë në shqyrtim nga Komisioni i Disiplinës pas 4 muajsh, në mbledhjen e datës 03.06.2020. Gjatë seancës dëgjimore znj. H pretendoi se për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid dhe mbylljes së shkollës, si dhe mungesës së ankueses në punë për 3-4 ditë, gjatë javës së parë të marsit, shqyrtimi i këtij propozimi në Komisionin e Disiplinës u krye në

qershor 2020. Ankuesja prapësoi se ajo kishte munguar në shkollë vetëm 2 ditë gjatë javës së parë të marsit.

Me shkresën nr.200 prot., datë 01.06.2020 ankuesja është njoftuar për t'u paraqitur pranë Komisionit të Disiplinës për t'u dëgjuar në datën 02.06.2020, ora 12.00. Sipas këtij njoftimi, nuk ka asnjë referencë se në lidhje me çfarë problematike do të zhvillohej kjo seancë para Komisionit të Disiplinës. Takimi i datës 02.06.2020 nuk është zhvilluar, por është shtyrë për në datën 03.06.2020. Sipas një njoftimi të mbajtur nga drejtuesja e institucionit, ky takim është shtyrë pasi në shkollë ishte administruar shkresa nr. 2703 prot., datë 02.06.2020, e dërguar nga ZVA Tiranë më të cilën përcillej ankesa e nxënëses E. Sh. ndaj mësueses A.B me pretendimin se kjo mësuese nuk kishte vlerësuar drejt këtë nxënëse. Ky njoftim i cili u depozitua në cilësinë e provës nga ana e znj. H, nuk rezultoi t'i jetë komunikuar palës ankuese dhe përfaqësuesve të saj të cilët kanë qenë prezent dhe duke pritur në ambientet e shkollës për takimin e njoftuar në datën 02.06.2020.

Nga aktet e administruara, rezultoi se Komisioni i Etikës dhe Sjelljes nuk është krijuar në përputhje me nenin 36/1, të Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (*Rregullores së IA*), i cili parashikon: *“1. Për të ndjekur çështjet që kanë të bëjnë me etikën, në çdo IA, në çdo fillim viti shkollor ngrihet dhe funksionon komisioni i etikës dhe i sjelljes. Drejtori i IA-së organizon procesin për ngritjen e komisionit të ri për çdo vit shkollor”*, pasi drejtuesja e këtij institucioni arsimor nuk rezultoi që në fillim të vitit shkollor të ketë ngritur komisionin e ri të etikës dhe të sjelljes. Rezultoi se, aktet e mbajtura nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, si procesverbalet e datës 12 dhe 14 shkurt 2020, si dhe procesverbali datë 13.02.2020 ku janë marrë firmat e nxënësve të klasës së 8 b, mbi bazën e të cilave ky komision ka arritur në propozimin e datës 17.02.2020, janë firmosur vetëm nga 4 anëtarë të Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, ndërkohë që numri i anëtarëve duhet të jetë 7, si dhe në mungesë të anëtarëve që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësve, kjo në kundërshtim me nenin 36/3/4, të Rregullores së IA, ku përcaktohet se: *“3. Komisioni përbëhet nga mësues, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënës, me të paktën 5 anëtarë. 4. Në IA-të me më pak se 24 klasa, komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, kurse në ato me të paktën 24 klasa përbëhet nga 7 anëtarë”*. Propozimi nr. 4, datë 17.02.2020, i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes gjithashtu ka mungesë të anëtarëve që përfaqësojnë nxënësit, një kërkesë kjo e detyrueshme sipas rregullimeve të sipërcitruara që bëhen nga Rregullorja e IA.

Në bazë të nenit 39/4 të Rregullores së IA, përcaktohet se: *“Komisioni shqyrton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore për palën ndaj të cilës propozohet masë disiplinore...”*. Nga aktet e administruara rezultoi se, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes është bazuar në vendimarrjen e tij edhe në procesverbalin e datës 13.02.2020, ku katër anëtarë të këtij komisioni, të gjitha mësuese, kanë marrë firmat e fëmijëve të klasës së 8b. Sipas procesverbalit të depozituar në cilësinë e provës nga znj. H, pasqyrohet se, fëmijëve u është bërë sondazh nga katër anëtarët e Komisionit të Etikës duke i pyetur se *“Kush mësues ishin prezent”*

gjatë pyetësorit të zhvilluar nga psikologia dhe nxënësit kanë pohuar se “mësuese I. M. doli jashtë klasës gjatë plotësimit të pyetësorit”. Ky procesverbal, i cili ka shërbyer si provë, nuk rezultoi t’i jetë vendosur në dispozicion ankueses gjatë shqyrtimit nga Komisioni Etikës dhe Sjelljes. Referuar deklaratave të lëshuara nga prindër të fëmijëve të cilët kanë nënshkruar procesverbalin e mësipërm, ata kanë ngritur shqetësimin për marrjen e firmave të fëmijëve të dhe përdorimin e tyre në procese gjyqësore, pa dijeninë e tyre. Fëmijët i’u kanë komunikuar prindërve se, kur kanë nënshkruar procesverbalin, ju është deklaruar se duhet të nënshkruanin ata që kishin marrë pjesë në pyetësin e zhvilluar nga psikologia, dhe jo në lidhje me pyetjen që parashtrohej në procesverbalin e datës 13.02.2020, pra në lidhje me prezencën e mësueses I.M në klasë. Këto reagime nga ana e prindërve ngrenë dyshime në lidhje me këtë akt ku është bazuar vendimarrja e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe Komisionit të Disiplinës.

Komisioni i Etikës dhe Sjelljes ka marrë vendimin e datës 17.02.2020 në kundërshtim me nenin 39/4 të Rregullores së IA, pasi nuk ka shqyrtuar dhe gjykuar në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Vendimi i Komisionit të Etikës ka cënuar të drejtën e ankueses për t’u njohur me aktet dhe provat e administruara, të drejtën për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për të paraqitur prova dhe pretendime në mbrojtje të saj.

Objekt shqyrtimi i Komisionit të Disiplinës gjatë takimit të datës 03.06.2020, ka qenë edhe shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Etikës së kësaj shkolle të datës 02.06.2020, lidhur me shqyrtimin e ankesës së paraqitur në MASR, ZVA Tiranë, si dhe në drejtorinë e shkollës, nga nxënësjja e klasës së 9-a, E.Sh. dhe prindërit e saj, ndaj mësueses A.B. Rezultoni se Komisionit të Etikës i është dorëzuar për shqyrtim ankesa e mësipërme në datën 02.06.2020 nga drejtoresha e shkollës, ankesë e cila ishte përcjellë nga ZVA Tiranë. Me një deklaratë me shkrim që i bashkangjitet akteve të administruara nga ky komision, rezultoni se nxënësjja E. Sh. dhe nëna e saj R. Sh., kjo e fundit rezultoni të jetë anëtare e Komisionit të Etikës, deklarojnë se nuk duan të ballafaqohen me mësuesen, pasi tashmë ishte vonë për të diskutuar në lidhje me këtë çështje dhe se mësuesja nuk kishte kontaktuar me ta që në fillim. Ato theksojnë se, ballafaqimin është kryer me telefon dhe se mësuesja gjatë komunikimit në vend që t’i qetësonte i ka shqetësuar më tepër. Në fund të deklaratës ato shprehen se, janë të lumtura që e drejta u vendosi në notën e vazhës. Kjo deklaratë nuk ka të shënuar datën kur është lëshuar.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve, në lidhje me ankesën e prindit dhe nxënëses E. Sh., rezultoni se, në datën 14.05.2020, nxënësjja në një komunikim në platformën *WhatsApp* të zhvilluar me ankuesen, pretendon se kjo e fundit ka manipuluar notat e saj të tremujorit të dytë. Brenda ditës, rezultoni se ankuesja ka komunikuar me nxënësen duke i vendosur në dispozicion kopje të regjistrit të vlerësimit të vazhduar me vlerësimet e nxënëses për periudhën janar - 9 mars 2020, tabelën shpjeguese, ka shpjeguar se regjistri kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga drejtorja e shkollës dhe se, bazuar në udhëzimin e kësaj të fundit, ankuesja kishte dorëzuar notat tek mësuesja kujdestare. Bazuar në komunikimin në platformën *WhatsApp*, rezultoni se, në datën 16.04.2020, drejtuesja e shkollës znj. H, ka udhëzuar se mësuesit e lëndëve duhet të vinin në dijeni

mësuesit kujdestar për vlerësimet e tremujorit të dytë dhe më pas mësuesit kujdestar do të përcillnin informacionin për të gjitha lëndët sipas klasave kujdestare. Nga aktet e vendosura në dispozicion rezulton se, ankuesja bazuar në udhëzimin e mësipërm ka dërguar me *email* në datë 17.04.2020, tek mësuesja kujdestare e klasës së 9a, vlerësimin për tremujorin e dytë.

Ankuesja evidenton se, gjatë komunikimeve me nxënësit, ajo ka theksuar se në vlerësimin përfundimtar do të mbahet parasysh për secilin angazhimi i tyre gjatë mësimit online për periudhën prill-maj 2020, bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, për vlerësimin e nxënësit në distancë. Në një komunikim të datës 15.05.2020 në platformën *WhatsApp*, prindi i nxënëses E.Sh., pretendon nga ankuesja se ka shkelur transparencën e vlerësimit, se ka fallsifikuar notën me gojë të vajzës si dhe kërkon nga mësuesja që t'i argumentojë se përse ka vlerësuar me notën 9 detyrën përmbledhëse të vajzës së saj. Në datën 24.05.2020, nëpërmjet komunikimit në platformën *WhatsApp*, ankuesja është njoftuar nga znj.H se duhet të paraqitet në shkollë në datën 26.05.2020, në lidhje me një ankesë që prindi i nxënëses E.Sh. kishte paraqitur në MASR në lidhje me vlerësimin e nxënëses nga ana e ankueses si mësuese e lëndës së gjeografisë për periudhën e dytë të vitit mësimor në vazhdimësi.

Ankuesja është paraqitur në takim në datën 26.05.2020, gjatë të cilit është mbajtur edhe procesverbali përkatës. Ajo ka vendosur në dispozicion të drejtoreshës informacion në lidhje me komunikimin e bërë me prindin e nxënëses që në datën 14.05.2020, kopje të esesë përmbledhëse, kriteret e vlerësimit, sqarimet që iu ishin bërë nxënësve përpara se të kryenin detyrën, regjistrin e vlerësimin të vazhduar periudha I dhe II, testi i periudhës së I të nxënëses E.Sh., testet e gjeografisë të nxënëses periudha I, II, III. Ankuesja ka dhënë sqarimet në lidhje me ankesën që i është komunikuar nga znj. H në datën 24.05.2020, pa patur në dispozicion kopje të ankesës që ishte depozituar ndaj saj. Kopja e ankesës i është vendosur në dispozicion ankueses me *email* datë 29.05.2020, nga ana e znj.H, pas kërkesave të vazhdueshme që ankuesja i kishte drejtuar me qëllim që të njëjët me kopjen e ankesës që ishte paraqitur ndaj saj.

Ndër të tjera në këtë *email*, znj.H, kërkon nga ankuesja që ajo të komunikojë me nxënësen dhe të bëjë gjithçka për t'a qetësuar, pasi që prej takimit të datës 26.05.2020, ankuesja nuk kishte krijuar asnjë lidhje me prindërit dhe nxënësen në lidhje me shqetësimin e tyre. Znj. H, me anë të këtij *emaili* i tëheq vëmendjen ankueses, duke u shprehur se ajo kishte patur kohë të reflektonte, t'a qetësonte nxënësen, t'a inkurajonte dhe t'a mbështeste pozitivisht atë duke shmangur efektet negative psikologjike. Znj.H i kërkon ankueses që brenda ditës së nesërme të marrë masa për të shmangur gjendjen e rënduar psikologjike të nxënëses duke komunikuar me prindin ose nxënësen dhe se neglizhenca nga ana e saj nuk do të tolerohej dhe do të shoqërohej me masë administrative.

Rezulton se ankuesja ka kontaktuar me prindin dhe nxënësen brenda datës 29.05.2020, por sipas këtyre të fundit ajo nuk i ka qetësuar por i ka shqetësuar. Ato nuk shpjegojnë se ku qëndronte shqetësimi i shkakuar nga ana e ankueses në komunikimin që ajo kishte patur me ato, përveç faktit se ankuesja gjatë komunikimit nuk ka pranuar se ka shkelur të drejtat dhe interesat e kësaj

nxënëse në vlerësimin që i ka bërë, ndërsa ankuesja shprehet se, pretendimi i palës tjetër ka qenë që ajo t'u premtonte notën 10, ndërkohë që ajo nuk mund t'a bënte këtë gjë pasi vlerësimi përfundimtar bëhej në qershor ndërsa shkolla ende nuk kishte përfunduar dhe një gjë e tillë do të përbënte shkelje nga ana e saj.

Komisioni i Etikës dhe Sjelljes ka marrë vendimin e datës 02.06.2020 në lidhje me ankesën e depozituar nga prindi i nxënëses E. Sh, duke i propozuar Komisionit të Disiplinës marrjen e masës disiplinore ndaj mësueses A.B, pasi ky komision kishte arritur në përfundimin se kjo mësuese kishte shkelur:- nenin 56/2 a,b,c; -udhëzimin e MASR për "*Vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë*", mbështetur në pjesmarrjen dhe angazimin e nxënësit gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë, mësuesi mund të rrisë një notë në vlerësimin përfundimtar të nxënësit si dhe;- shkelje të dokumentacionit shkollor për dy nxënës A. Gj. dhe L. Xh.

Komisioneri konstaton se, vendimi i mësipërm i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, është marrë në kundërshtim me parashikimet e Rregullores për IA. Vendimi i datës 02.06.2020, është marrë vetëm nga 4 anëtarë, ndërkohë që ky komision për shkollat që kanë më shumë se 24 klasa duhet të përbëhet nga 7 anëtarë dhe ka mungesë në përbërjen e tij, pasi mungojnë anëtarët që përfaqësojnë komunitetin e prindërve dhe nxënësit. Rezulton gjithashtu se, Komisioni i Etikës me anë të këtij vendimi ka cënuar të drejtën e ankueses për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur pretendimet e saj. Ankuesja nuk është njoftuar në asnjë moment për marrjen në shqyrtim të ankesës nga ana e këtij komisioni dhe nuk ka patur dijeni për vendimin e marrë nga ky komision. Rezulton se ankuesja ka marrë dijeni në lidhje me vendimin e datës 02.06.2020 të Komisionit të Etikës gjatë takimit të zhvilluar në datën 03.06.2020 në mbledhjen e Komisionit të Disiplinës.

Komisioneri konstaton se, ankuesja nuk ka patur dijeni në lidhje me objektin për të cilin po zhvillohej takimi i datës 03.06.2020 në Komisionin e Disiplinës dhe është njohur vetëm gjatë zhvillimit të këtij takimi. Gjatë takimit të datës 03.06.2020, të Komisionit të Disiplinës, rezulton se është referuar raporti i vëzhgimit i përcjellë ZVA Tiranë. Komisioneri konstaton se, ky raport vëzhgimi i është komunikuar vetëm shkollës dhe ankuesja ka marrë dijeni për këtë dokument gjatë takimit të datës 03.06.2020. Ankuesja dhe përfaqësuesit e saj janë shprehur në takim se nuk kanë dijeni dhe nuk mund të japin shpjegime në lidhje me këtë akt që iu vendosej në dispozicion vetëm gjatë takimit. Komisioni i Disiplinës në vendimin e tij ka referuar këtë raport vëzhgimi të ZVA Tiranë duke cituar se, ky raport ka dalë në konkluzionin që në shkollë është krijuar një klimë jo shumë pozitive midis mësuesve, problematika në komunikim dhe konflikt midis mësuesve, të cilët referojnë si shkaktarin kryesor mësuese A.B.

Bazuar në raportin e vëzhgimit të administruar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës Komisioneri konstaton se, raporti i vëzhgimit ishte kryer me qëllim shqyrtimin e ankesës që kishte depozituar ankuesja ndaj drejtueses së shkollës, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i dokumentacionit shkollor. Ekipi i vëzhgimit kishte realizuar një pyetësor në shkollë në datën 25.02.2020, ku ishin përfshirë 60 nxënës të klasave të 8-ta dhe 28 mësuesit prezent në këtë datë.

Në përfundim të monitorimit, është arritur në konkluzionin se: *“Nga ana e drejtorisë së shkollës është bërë ndarja e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2019-2020 në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 ‘Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit të parauniversitar’. Është bërë ndryshimi i orarit mësimor gjatë fillimit të muajit tetor. Në shkollë është krijuar një klimë jo shumë pozitive midis mësuesve duke manifestuar problematika në komunikim dhe konflikte midis mësuesve të cilët referojnë si shkaktarin kryesor A. B”*. Në përfundim të monitorimit, ekipi i vëzhguesve të ZVA Tiranë ka rekomanduar: *“Nga ana e drejtuesve të institucionit arsimor duhet të punohet më shumë për të krijuar një klimë pozitive midis mësuesve””*.

Ekzistenca e konflikteve midis ankueses dhe disa mësuesve të shkollës është një fakt i cili pranohet edhe nga vetë ankuesja, e cila shprehet se është gjendur në mënyrë të vazhdueshme gjatë tre viteve të fundit në konflikt me disa kolegë dhe se nga ana e drejtueses së institucionit nuk është marrë asnjë masë për zgjidhjen e këtyre situatave. Monitorimi i kryer nga ZVA Tiranë konfirmon ekzistencën e konflikteve në mjediset e shkollës midis mësuesve, por ky ekip nuk rezulton të ketë shqyrtuar dhe të ketë konkluduar ai vet në lidhje me faktin se kush është përgjegjës në lidhje me këtë situatë konfliktuale. Ekipi i vëzhguesve i ka lënë detyrë drejtuesve të institucionit arsimor që të punojnë më shumë për të krijuar një klimë pozitive midis mësuesve.

Në lidhje me ankesën e prindit të nxënësës E.Sh, Komisioni i Disiplinës ka konstatuar se, ankuesja A.B, në cilësinë e mësueses së lëndës së gjeografisë nuk ka argumentuar vlerësimin e periudhës së dytë në lëndën e gjeografisë gjatë mësimin në distancë për shkak të covid-19, nuk i ka kthyer përgjigje, dhe nuk ka bërë transparent rezultatet e marra në detyrën përmbledhëse. Bazuar në provat e vendosura në dispozicion nga ana e znj. H, Komisioni i Disiplinës ka arritur në këtë përfundim, sikurse referohet edhe në vendim, duke u bazuar në analizimin e komunikimeve me sms në platformën *WhatsApp*. Referuar këtyre komunikimeve të vëna në dispozicion nga znj. H, Komisioneri konstaton se këto komunikime kanë të bëjnë me bisedat e zhvilluara midis nxënësës E. Sh. e cila iu drejtohet nxënësve të tjerë të klasës duke i pyetur nëse ata mbanin mend notat që ajo kishte marrë gjatë periudhës së dytë. Gjatë bisedës së zhvilluar midis nxënësve, konstatohet një fjalor jo etik i nxënësve ndaj ankueses, ku njëri prej tyre shprehet: *“Ska gjë E... ne e dimë të gjithë se ajo është idiote dhe ti nuk ke asnjë faj”*.

Komisioni i Disiplinës, pasi ka shqyrtuar çështjen në lidhje me të dyja pikat që ishin objekt shqyrtimi, ka arritur në përfundimin se, mësuese A.B, ka vepruar në kundërshtim me rregulloren *“Për funksionimin e Institucioneve Arsimore”*, neni 56, pika a dhe b dhe neni 34. Vendimi i Komisionit të Disiplinës datë 03.06.2020, referon tek neni 56 i Rregullores së IA, por pa specifikuar pikën përkatëse, ndërsa kjo dispozitë e rregullores ka 2 pika në përmbajtjen e saj. Meqënëse kemi të bëjmë me pretendimin se ankuesja ka shkelur detyrën, atëherë Komisioneri gjykon të referojë tek pika e 2, neni 56, të Rregullores së IA, të cituar në vendimin e Komisionit të Disiplinës. Në pikën 2, gerrat a dhe b, të neni 56, të Rregullores së IA, parashikohet: *“Mësuesi ka për detyrë: a) të përmbushë detyrimet që lidhen me ushtrimin e profesionit të mësuesit; b) të*

zbatojë Kodin e Etikës së Mësuesit”. Për sa i përket referimit tek neni 34, i Rregullores së IA, Komisioni i Etikës nuk ka bërë asnjë specifikim se çfarë detyrimi ka shkelur ankuesja në lidhje me respektimin e rregullave të etikës, pasi kjo dispozitë ka një sërë përcaktimesh dhe detyrimesh, e për pasojë Komisioni duhet të kishte identifikuar se cilën prej tyre ka shkelur ankuesja me sjelljen e saj. Komisioneri vlerëson se, parashikimet e nenit 34, të Rregullores së IA nuk mund të gjejnë të gjitha zbatim në rastin konkret dhe se duhet të ishin specifikuar nga ana e Komisionit të Disiplinës.

Në lidhje me shqyrtimin e ankesës së mësuese I.M., Komisioni i Disiplinës shprehet se, është një rast i përsëritur nga ana e ankueses, por një pretendim i tillë nuk rezulton i provuar, pasi ndaj ankueses nuk rezulton të jetë dhënë më parë ndonjë masë disiplinore për shkelje të të njëjtës natyrë. Bazuar në nenin 107/2, të Rregullores së IA, përcaktohet se: *“Masat e përshkallëzuara që Komisioni i Disiplinës vendos për mësuesin ose nëndrejtorin, në varësi të llojit të shkeljes apo përsëritjes së të njëjtës shkelje janë: a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna; ç) largim nga puna.”*

Komisioneri vlerëson se masa disiplinore e dhënë ndaj ankueses *“Paralajmërim për largim nga puna”* është jo proporcionale në raport me shkeljet e pretenduara. Kjo masë disiplinore është gjithashtu në kundërshtim me parimin e përshkallëzimit të parashikuar nga neni 107/2 të Rregullores së IA-së, lidhur me dhënien e masave disiplinore nga ana e Komisionit të Disiplinës. Bazuar në rrethanat e çështjes, kur ndaj ankueses nuk ka asnjë masë disiplinore të mëparshme në fuqi, si dhe duke mbajtur parasysh shkeljet që pretendohet se janë kryer nga ankuesja, dhënia e masës disiplinore *“Paralajmërim për largim nga puna”* përbën një masë flagrante. Minimalisht, ndaj ankueses duhet të ishin aplikuar masa disiplinore për të lehta, duke filluar nga *“Qortim”*.

Bazuar në gjithë konstatimet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se, masa disiplinore e marrë ndaj ankueses është produkt i një procesi të zhvilluar në kundërshtim me të drejtën e ankueses për t’u informuar në lidhje me ankesat ndaj saj, në shkelje të parimit të kontradiktorialitetit, në shkelje të të drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Gjatë të gjithë procedurës së ndjekur për marrjen e masës disiplinore, nuk rezulton që pretendimet dhe provat e depozituara nga ankuesja të jenë marrë në shqyrtim dhe të jetë dhënë një vlerësim nga ana e të dy komisioneve, si nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, ashtu edhe nga Komisioni i Disiplinës. Në mënyrë flagrante dhe të pabazuar ndaj ankueses është dhënë një masë disiplinore e rëndë sikurse është *“Paralajmërim për largim nga puna”*, në shkelje të parimit të proporcionalitetit, i cili kërkon dhënien e masës disiplinore në mënyrë të përshkallëzuar.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për mosdhënien e ngarkesës mësimore, gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se ankuesja ka marrë ngarkesë të plotë mësimore sipas parashikimeve përkatëse ligjore prej 20 orë mësimore në total.

Komisioneri nuk do të shprehet në lidhje me pranueshmërinë ose jo të objektit të shtuar nga ana e ankueses, në lidhje me pretendimin për diskriminim të fëmijëve të saj si dhe pretendimet për diskriminim ndaj anëtarëve të Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës, pasi çmon se në konkluzionet e saj përfundimtare duke mos i pretenduar, ankuesja ka hequr dorë prej tyre.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja A.B është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë gjithë procedurës disiplinore që është finalizuar me dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”, me vendimin e datës 03.06.2020 të dhënë nga Komisioni i Disiplinës së Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria”.

B. Shkaku i mbrojtur

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, sipas përmbajtjes në vijim: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”**

Bazuar në nenin 9/2 të Kodit të Punës, i cili përbën edhe legjislacionin mbi bazën e të cilit rregulloren marrëdhëniet e punës së ankueses, përcaktohet se : “2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”, duke garantuar në këtë mënyrë mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.**

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, ankuesja pretendon se është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*” ankuesja pretendon se është diskriminuar si pasojë e paraqitjes së ankesës ndaj znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria”, Tiranë.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, ankuesja sqaroi se ky pretendim konsistonte në faktin se ajo ka dëgjuar më shumë se një herë fjalë se ajo synon që të zërë vendin e drejtoreshës pasi ka më shumë kualifikime se ajo. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankueses se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore është i pabazuar.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “ankesës” rezulton se, në datë 14.02.2020, ankuesja ka paraqitur një ankesë në ZVA Tiranë kundër znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, për shkak të shqetësimeve në punë nga ana e disa kolegëve të tjerë që ankuesja po kalonte prej gati tre vitesh. Paraqitja e kësaj ankese në ZVA Tiranë është një fakt i njohur për znj. H dijenia për të cilën u pranua prej saj gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës. Komisioneri gjykon se, diferenca në trajtim bazuar në faktin se, personi ka paraqitur “ankesa” kundër punëdhënësit, duhet të gëzojë mbrojtje nga diskriminimi dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se ankuesja e mbart këtë shkak.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁶, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*⁷ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes ose shtrembërimit e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

*Karta Sociale Europiane*⁸ në nenin 1, pika 2, parashikon: “Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim⁹. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet mbrojtja nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

Bazuar në nenin 3, pika 1 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Ligji, parashikon disa forma përmes të cilave mund të shfaqen sjelljet diskriminuese. Konkretisht në nenin 3, pikat 13 dhe 17 të këtij ligji, parashikohet se: “..... 13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë. 17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimit a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.....”

⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁸ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

⁹ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituaniës*, prg 30.

Në nenin 5, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet se : “ 1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”

Kodi i Punës në nenin 9/2, të tij sanksionon: “1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”

Në Kreun II, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Konkretisht ky ligj, në nenin 12/1/c, parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”

Në bazë të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlegjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”. Ndërsa në nenin 9/3 të Kodit të Punës përcaktohet se: “3. Ndalimi i diskriminimit, i përcaktuar nga ky Kod, nuk zbatohet nëse nuk ekziston një përlegjje e arsyeshme dhe objektive.”

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁰ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e

¹⁰ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.” I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës, parashikohet edhe në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, ku përcaktohet se: “10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesja duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹¹

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

¹¹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht¹²”.

Pavarësisht pretendimeve të ankueses se përgjatë tre viteve të fundit ka përjetuar shqetësime të vazhdueshme që lidhen kryesisht me marrëdhëniet e punës me kolegët dhe me drejtuesen e institucionit arsimor, ajo pretendon se, situata e diskriminimit në ambientin e punës ka precipituar, pas një ankese të bërë nga ana e saj në drejtim të drejtoreshës së institucionit znj. E.H, që mban datën 14.02.2020. Është kjo ankesë e cila ka sjellë për pasojë dhënien e masës disiplinore të padrejtë ndaj ankueses, në kundërshtim të hapur me parimet themelore të Kodit të Punës, Kodit të Procedurave Administrative, Rregulloreve që normojnë procesin mësimor në institucionet parauniversitare.

Bazuar në analizën e mësipërme, rezultoi e provuar se ankuesja A.B është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë gjithë procedurës disiplinore që është finalizuar me dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”, me vendimin e datës 03.06.2020 të dhënë nga Komisioni i Disiplinës së Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria”.

Ekzistenca e marrëdhënieve konfliktuale dhe klimës jo pozitive midis ankueses dhe disa mësuesve të tjerë, sikurse edhe ankuesja e ka pretenduar, rezulton e provuar që ka ekzistuar që para se ankuesja të paraqiste ankesën e saj në datën 14.02.2020 kundër znj. H, në cilësinë e drejtueses së institucionit arsimor. Ka qenë pikërisht fakti se znj. H nuk ka marrë asnjë masë për të adresuar shqetësimet në vendimin e punës të pretenduara nga ankuesja, që e kanë detyruar këtë të fundit të të paraqes këtë ankesë pranë ZVA Tiranë.

Sikurse rezultoi gjatë shqyrtimit, ankuesja është ankuar në disa raste ndaj disa mësuesve në ZVA Tiranë, si në lidhje me problematikat e saj në vendin e punës, por edhe në lidhje me djalin e saj, i cili ka qenë për një periudhë nxënës në këtë shkollë. Për këto ankesa kanë marrë dijëni si drejtuesja e institucionit znj. H ashtu edhe mësuesit respektiv për të cilët znj.B është ankuar. Megjithatë, rezulton se, përpara datës 14.02.2020, ankuesja i ka drejtuar ankesat e saj ndaj mësuesve të tjerë dhe jo ndaj znj. H, drejtores e shkollës, ndryshe nga sa ka ndodhur me ankesën e datës 14.02.2020, e cila është paraqitur kundër saj.

¹² GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Znj. H, gjatë seancës dëgjimore pretendoi se procedura ndaj ankueses në Komisionin e Disiplinës kishte filluar përpara se ajo të paraqiste ankesën ndaj saj. Bazuar në kronologjinë e ngjarjeve kur ka filluar procedura e parë ndaj ankueses në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes rezulton se:

- Mësuese I. M. ka paraqitur ankesë ndaj ankueses, në datë 05.02.2020.
- Komisioni i Etikës dhe Sjelljes ka marrë në shqyrtim ankesën dhe në vijim ka mbajtur procesverbalin e datës 12.02.2020, procesverbalin e datës 13.02.2020 si dhe procesverbalin e datës 14.02.2020.
- Në datë 14.02.2020 ankuesja ka depozituar ankesën pranë ZVA Tiranë dhe deri në këto momente, procedura e filluar nuk ishte finalizuar nga ana e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes.
- Në datë 17.02.2020, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes pa asnjë njoftim ndaj ankueses ka dalë me vendimin për të propozuar marrjen e masës disiplinore ndaj ankueses lidhur me ankesën e paraqitur nga mësuese I. M.

Sa më sipër rezulton se, procedura para Komisionit të Etikës dhe Sjelljes ka filluar përpara se ankuesja të paraqiste ankesën e saj ndaj znj. H në ZVA Tiranë, por vendimi i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes me të cilin është propozuar marrja e masës disiplinore ndaj ankueses nga Komisioni i Disiplinës, ka ndodhur pas paraqitjes së ankesës ndaj znj. H.

Pavarësisht ekzistencës së konflikteve apo ankesave që ankuesja ka paraqitur, nuk rezulton që përpara datës së paraqitjes së ankesës drejtuar drejtueses së institucionit ndaj saj të jetë ndërmarrë ndonjë procedurë disiplinore.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve, në lidhje me procedurën e dytë ndaj ankueses në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes, rezulton se :

- Në datën 24.05.2020, ankuesja është njoftuar nga drejtuesja e institucionit znj. H se ndaj saj ishte paraqitur një ankesë lidhur me vlerësimin e nxënëses E. Sh., klasa e 9 a.
- Në datën 26.05.2020 është realizuar një takim midis ankueses, drejtueses së institucionit znj. H dhe nëndrejtoreshës së institucionit znj. A.S., në lidhje me ankesën prindit të nxënëses E. Sh.
- Në ditët në vijim 26, 27, 28, 29 maj 2020, ankuesja ka depozituar gjithë dokumentacionin dhe shjegimet e saj në lidhje me vlerësimin e nxënëses E. Sh., me ankesën e të cilës është njohur në datën 29.05.2020, pas disa kërkesave që i ka bërë znj. H.
- Në datën 02.06.2020 ishte planifikuar thirrja e ankueses për t'u paraqitur në Komisionin e Disiplinës, por pa u vënë në dijeni në lidhje me temën e këtij takimi.
- Takimi i datës 02.06.2020 shtyhet në datën 03.06.2020, por pa njoftuar ankuesen mbi arsyet e shtyerjes.
- Në të njëjtën ditë, pra datë 02.06.2020, janë administruar në shkollë dy shkresa të përcjella nga ZVA Tiranë, me të cilat, me njëjërën përcillej ankesa e prindit të nxënëses E.Sh. dhe me shkresën tjetër përcillej raporti i monitorimit/vëshgimit të realizuar nga ZVA Tiranë në datën 25.02.2020, në lidhje me ankesën e paraqitur nga ankuesja.

- Asnjë nga dy aktet e mësipërme të përcjella nga ZVA Tiranë nuk i janë bërë me dije ankueses para takimit të Komisionit të Etikës të datës 03.06.2020.
- Në datën 02.06.2020, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes ka marrë në shqyrtim ankesën e bërë në lidhje me vlerësimin e nxënëses E.Sh., në mungesë të ankueses dhe ka propozuar marrjen e masës disiplinore ndaj saj.
- Në datën 03.06.2020 Komisioni i Disiplinës ka marrë në shqyrtim dy propozimet e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe ka vendosur marrjen e masës disiplinore ndaj ankueses “Paralajmërim për largim nga puna”, ndërkohë që rezulton se ankuesja nuk ka patur dijeni për propozimet e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, për raportin e vëzhgimit të ZVA Tiranë dhe një fakt i tillë i është bërë me dije Komisionit të Disiplinës gjatë seancës dëgjimore datë 03.06.2020.

Në kronologjinë e ngjarjeve të ndodhura pas paraqitjes së ankesës ndaj drejtueses së institucionit, rezulton se, në datë 18.02.2020, 27 mësues të Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria” kanë paraqitur në ZVA Tiranë një ankesë në formë peticioni kundër mësuese A.B. Në këtë ankesë/peticion shënohet se kjo gjë bëhet me dijeni të drejtoreshës. Mësuesit shprehen se prej tre vitesh konfliktet midis ankueses dhe pjesës dërrmuese të kolektivit kanë qenë të vazhdueshme, dhe sipas tyre ankuesja ngre akuza të pabazuara dhe të pafaktuara. Ata i drejtohen ZVA Tiranë duke i kërkuar ndihmë, pasi sipas tyre mësuese A.B gishtin e drejton gjithmonë ndaj të tjerëve pa pranuar asnjë lloj përgjegjësie individuale.

Gjatë seancës dëgjimore, nga ana e znj. H, fillimisht u paraqit një situatë e cila binte shumë në kontraditë me pretendimet e ngritura nga ankuesja lidhur me një situatë dhe klimë jo pozitive që ekzistonte në kolektiv. Sikurse rezultoi edhe gjatë seancës, ku vet znj. H konfirmoi se në disa raste ankuesja kishte ngritur shqetësime në lidhje me punën dhe i kishte paraqitur ato jashtë institucionit arsimor. Ndërkohë edhe raport monitorimi i zhvilluar nga ZVA Tiranë në datën 25.02.2020, nxjerr në pah klimën jo pozitive që ekziston në kolektivin e këtij institucioni arsimor.

Rezulton se, peticioni/ankesa i/e datës 18.02.2020 (peticion/ankesë paraqitur katër ditë pas ankesës së znj. B në ZVA Tiranë) është firmosur nga 27 mësues ose 77 % e mësuesve, nga 35 mësues në total që ka shkolla. Referuar raportit të monitorimit/vëzhgimit, të realizuar nga ZVA Tiranë, në datën 25.02.2020, rezulton se, nga 28 mësuesit që kanë marrë pjesë në pyetësor, vetëm 22 % e tyre kanë deklaruar se kanë probleme në komunikim vetëm me mësuese A.B. Në të dyja rastet konstatohet se, numri total i mësuesve është pothuajse i njëjtë, 27 mësues kanë firmosur peticionin e datës 18.02.2020, ndërsa 28 mësues kanë marrë pjesë në pyetësorin e zhvilluar në datë 25.02.2020 nga ZVA Tiranë. Sa më sipër, konstatohet se, mësuesit deklarohen se kanë problematika në komunikim me ankuesen, në një përqindje më të lartë (77%) në rastin e nënshkrimit të peticionit të datës 18.02.2020, peticion i nënshkruar me dijeninë e drejtores së institucionit, ndërsa deklarohen në një përqindje shumë herë më të vogël (22%) në pyetësorin e zhvilluar nga ZVA Tiranë në datën 25.02.2020.

Komisioneri rithekson se, raporti i ZVA Tiranë nuk ka konstatuar ose konkluduar në ndonjë përgjegjësi të ankueses në gjithë këtë situatë konfliktuale, por për situatën e konstatuar ka lënë detyra për drejtuesit e institucionit arsimor. Ky rekomandim i vëzhguesve të ZVA Tiranë është administruar në shkollë në datën 02.06.2020 dhe i është komunikuar ankueses vetëm gjatë takimit të Komisionit të Disiplinës datë 03.06.2020. Komisioneri gjithashtu vlerëson se, ky raport vëzhgimi nuk është interpretuar drejtë, duke u paraqitur si një akt i cili ngarkon me përgjegjësi ankuesen në lidhje me situatat konfliktuale të krijuara midis kolegëve. Konstatohet se, në raportin e vëzhgimit të kryer nga ZVA Tiranë, janë ngritur nga nxënësit, të cilët gjithashtu kanë qenë të përfshirë në pyetësor, problematika të rënda siç është ajo e marrjes së lekëve nga ana e mësuesve dhe sjellje jo etike që mësues të përmendur në raport kanë ndaj nxënësve. Bazuar në të dhënat e pyetësorit të zhvilluar me nxënësit, ankuesja A.B nuk referohet në asnjë rast nga ana e nxënësve për sjellje jo etike ose për fenomene të tjera siç është ajo e shitblerjes së notës.

Bazuar në nenin 41/6 të Rregullores së IA, përcaktohet se : *“Kryetari i Komisionit u dorëzon propozimet, që i ka dërguar drejtorit, edhe kryetarit të bordit dhe kryetarit të këshillit të prindërve”* . Vendimarrja e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes rezulton që të jetë kryer jo vetëm në mungesë të ankueses, por nuk rezulton që të jenë vendosur në dijeni aktorët e mësipërm. Bazuar në vlerësimet e performancës në punë, lëshuar nga Kryetari i Bordit të Shkollës Dora d’Istria datë 01.07.2020, si dhe nga Bordi i Prindërve të Klasës së 8b, lëshuar në datë 08.06.2020, e cila është në kujdestari të ankueses, ankuesja vlerësohet me konsideratat më të larta për punën e saj si mësuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë human.

Znj.H, prapësoi pretendimin e ankueses për diskriminim nga ana e saj, duke pretenduar se ajo nuk është anëtare e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, i cili ka propozuar marrjen e masës disiplinore ndaj saj. Ajo gjithashtu u shpreh se masa disiplinore është vendim i Komisionit të Disiplinës, i cili ka në përbërje të tij disa anëtarë dhe ku drejtori i institucionit arsimor është njëri prej tyre dhe ka një votë.

Drejtuesi i institucionit arsimor bazuar në nenin 36/8 të Rregullores së IA, nuk është anëtar i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe referuar nenit 107 të po kësaj rregullore, masat disiplinore ndaj mësuesve jepen nga Komisioni i Disiplinës dhe jo nga Drejtori i institucionit arsimor. Por, drejtuesi i institucionit arsimor, bazuar në nenin 101 të rregullores së sipërcituar, është ai që kryeson këtë komision dhe drejton punën e tij.

Drejtori i institucionit arsimor, bazuar në nenin 42/3 të Rregullores së IA, ka përgjegjësinë për zbatimin në institucionet arsimore të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, ndërsa bazuar në nenin 42/5, të po kësaj rregullore, drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësinë për krijimin në institucion të klimës së bashkëpunimit dhe të respektit ndërmjet punonjësve arsimorë në institucion. Ky është edhe rekomandimi që i është lënë drejtuesve të shkollës, nga raporti i vëzhgimit i kryer nga ZVA Tiranë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se anëtarë të Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, por edhe anëtarë të Komisionit të Disiplinës, kanë patur konflikte të drejtpërdrejta me ankuesen dhe për të cilat kjo e fundit ka paraqitur edhe ankesa. Rezulton se ndaj mësueses L.A, Kryetare e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe mësueses M.B, anëtare e këtij komisioni (të dyja mësuese të biokimisë), ankuesja, jo vetëm që ka ngritur në vazhdimësi shqetësimin në lidhje shpërndarjen e orëve mësimore që i përkasin departamentit ku bën pjesë ankuesja, por edhe i ka materializuar këto ankesa në ankesën e depozituar në datë 14.02.2021 në ZVA Tiranë. Anëtarja e Komisionit të Disiplinës mësuesja A.L, gjithashtu rezulton të jetë përfshirë drejtëpërsëdrejti në mosmarrëveshje me ankuesen, gjatë periudhës që ankuesja ka patur djalë e saj nxënës në shkollë. Ankesat ndaj kësaj mësueseje janë paraqitur në ZVA Tiranë që nga viti 2019 dhe janë përfshirë edhe në ankesën e fundit që ankuesja ka paraqitur në ZVA Tiranë. Pavarësisht se znj. H, ka patur dijeni, ajo nuk ka marrë masa për të shmangur këtë situatë, ku pjesëmarrja e mësueseve të cilat kanë patur konflikte me ankuesen mund të përbënte arsye serioze për njëanshmëri në procedurën disiplinore kundra ankueses. Konstatohet se, të gjithë mësuesit pjesë e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe Komisionit të Disiplinës, të cilët kanë nënshkruar petitionin/ankesën e datës 18.02.2020, ndaj ankueses. Znj. H, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Disiplinës, gjithashtu ka qenë në konflikt interesi, pasi ndaj saj ishte paraqitur ankesa në ZVA Tiranë.

Gjatë procedurës së ndjekur lidhur me ankesën e mësueses I. M., rezulton se ankuesja ka paraqitur nëpërmjet një ankese me shkrim shqetësimin pranë znj.H, se anëtarët e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes nuk i kanë vendosur në dispozicion ankesën dhe provat në lidhje me ankesën, por ajo nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me këtë ankesë të paraqitur nga znj. B. Gjithashtu, ankuesja ka paraqitur shqetësimin e saj pranë znj. H, se një nga anëtarët e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, mësuese M.B, ka përdorur ndaj saj fjalë jo etike, por znj. H në cilësinë e drejtuesit të institucionit nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të adresuar këtë shqetësim të ankueses. Komunikimet jo etike të nxënësve të klasës së 9-a ndaj ankueses, të cilat janë administruar gjatë procedurës disiplinore ndaj ankueses nga ana e të dy komisioneve, nuk kanë shërbyer si indicie për t'u shqyrtuar për shkelje të Kodit të Etikës në institucionin arsimor.

Bazuar në tërësinë e informacionit dhe akteve të administruara rezulton se, e gjithë procedura disiplinore e zhvilluar ndaj ankueses është kryer në kushtet kur Komisioni i Etikës dhe Sjelljes është ngitur në kundërshtim me Rregulloren e IA, ka patur anëtarë të cilët kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit me ankuesen, për shkak të ankesave që ajo ka bërë ndaj tyre. Me vendimin nr.241, datë 02.02.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 03.06.2020, të Komisionit të Disiplinës, me të cilin është dhënë masa disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*” ndaj ankueses, pasi ka konstatuar se ky vendim ka qenë produkt i një procesi administrativ të cënueshëm dhe absolutisht të pavlefshëm. Sa më sipër, moszbatimi i ligjit dhe procedurave të posaçme, të cilat janë përgjegjësi e drejtorit të institucionit arsimor, duke e vendosur ankuesen para një komisioni të njëanshëm dhe jo

transparent, vendimi i të cilit parashikohej të ishte i njëanshëm dhe negativ ndaj saj, ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë znj.E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë.

Referuar ankesës që ankuesja ka depozituar në ZVA Tiranë, që pretendohet prej saj se ka sjellë precipitimin e situatës dhe ndërmarrjen kundër saj të procedimeve disiplinore të padrejta të finalizuara me dhënien e masës disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”, rezulton se ankuesja ka ngritur pretendime për sjellje diskriminuese.

Në nenin 3, pika 17, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet : “17. “*Viktimizimi*” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimesi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.”

Komisioneri gjykon se bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e mësipërme, si dhe të gjitha provat e administruara, krijohet prezumimi se masa disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”, jo vetëm që është e pabazuar dhe disproporcionale, por është pasojë negative që ka ardhur si rezultat i paraqitjes së ankesës, duke përfshirë pretendimet për diskriminim, pranë ZVA Tiranë, nga ana e ankueses kundër znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1, të ligjit nr. 10221/2010“*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, dhe nenit 9, pika 10, të Kodit të Punës, i ndryshuar, znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, kishte barrën e provës që të provonte se masa disiplinore ndaj ankueses nuk është bërë për shkak të ankimit të saj në ZVA Tiranë, ose që masa disiplinore është dhënë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses se masa disiplinore është dhënë për shkakun e pretenduar. Në mungesë të një justifikimi të tillë i vetmi shpjegim për dhënien e masës disiplinore ndaj ankueses, “*Paralajmërim për largim nga puna*”, mbetet fakti i paraqitjes së ankesës, ku përfshihet pretendimi për diskriminim, pranë ZVA Tiranë, kundër znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë.

Në bazë nenit 35, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ku përcaktohet: “*Çdo person mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij ligji, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka kryer një akt diskriminues në kuptimin e këtij ligji. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e shtetit ose të personit juridik privat.*”, znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë, mban përgjegjësi individuale që me veprimet dhe mosveprimet e saj ka lejuar moszbatimin e ligjit dhe procedurave të posaçme, të cilat janë përgjegjësi e drejtorit të institucionit arsimor, duke e ekspozuar ankuesen A.B ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja A.B është diskriminuar nga ana e znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes së ankesës, në ZVA Tiranë. Për rrjedhojë znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 e 17 dhe nenit 5, pika 1, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Të gjitha veprimet dhe mosveprimet në shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi bazën e të cilave normohet dhe rregullohet veprimtaria në një institucion arsimor publik, nga ana e znj. H, në cilësinë e drejtores së shkollës, duke përdorur organet e këtij institucioni kanë krijuar një klimë dhe një mjedis armiqësor ndaj ankuses, duke e bërë atë objekt të procedurave disiplinore. Në vijimësi ankuesja është ndjerë e shqetësuar në vendin e saj të punës, por nuk rezulton që të jetë ndërmarrë ndonjë procedurë për verifikimin e tyre, qoftë edhe për të konkluduar se pretendimet e saj kanë qenë të pabaza. Në momentin që ankuesja ka kundërshtuar duke mospranuar sjelljet e padëshiruara në vendin e punës, ajo është vendosur në kushte të pafavorshme dhe përballë proceseve disiplinore, të zhvilluara në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi dhe duke cënuar rëndë të drejtën e ankuses për një proces të rregullt ligjor. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja A.B, është diskriminuar në formën e shpetësimit, nga ana e znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, e cila ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 e 13 dhe nenit 5, pika 1, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri konstaton se, nga ana e ZVAP Tiranë, nuk rezulton të jenë marrë masat e duhura për të trajtuar në mënyrë efektive ankesat dhe shqetësimet e paraqitura nga ana e ankuses në ankesën e saj drejtuar këtij institucioni. Duke referuar në raportin e vëzhgimit të datës 25.02.2020, të kryer nga ZVAP Tiranë, ky raport nuk ka arritur në asnjë konkluzion në lidhje me ankesat e ngritura nga ankuesja. Ky raport nuk i është vendosur dhe njoftuar ankuses, por i është përcjellë vetëm Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, edhe pse është kryer për të verifikuar ankesën e paraqitur nga znj. B.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur

kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuuese është ndalimi i shqetësimit dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme, të cilat çenojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a dhe 33 pikat 10, 11, 12 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankueses A.B, nga ana e znj. E. H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, Tiranë.
2. Konstatimin e diskriminimit në formën e shqetësimit, të ankueses A.B, nga ana e znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, Tiranë.
3. Në referim të konstatimeve të mësipërme, të merren masa për ndalimin e shqetësimit dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme, të cilat çenojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.
4. Komisioneri rekomandon Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, që të trajtojë në mënyrë efektive ankesat që i paraqiten.
5. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, znj. E.H, Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shakaku: çdo shkak tjetër/“ankesat kundër drejtueses së institucionit”
Fusha : punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim
Forma: viktimizim/shqetesim